



FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

RAPORTI VJETOR 2020



FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

PËRMBAJTJA

04 PJESA I - INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

- 06 Fjala e Kryesuesit të Bordit dhe Drejtorit Menaxhues
 - 08 Akronimet
 - 09 Përmbledhje e treguesve financiarë
-

10 PJESA II - PROFILI I INSTITUCIONIT

- 12 Themelimi i FK GK-së dhe statusi i saj
 - 12 Misioni
 - 13 Vlerat institucionale
-

14 PJESA III - QEVERISJA KORPORATIVE

- 16 Bordi i Drejtorëve dhe personeli
 - 19 Struktura organizative
 - 20 Komitetet
 - 20 Komiteti i Menaxhimit të Riskut
 - 20 Komiteti i Auditimit
-

22 PJESA IV - PERFORMANCA E FK GK-së

- 24 Zhvillimi i portofolit të garancive
 - 28 Garantimi i agro financimit përmes Dritares Agro
 - 35 Menaxhimi i riskut kreditor
 - 37 Struktura e kapitalit dhe investimet
 - 39 Sistemit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social
 - 40 Veçoria e vitit 2020
-

42 PJESA V - AKTIVITETET GJATË VITIT 2020

- 44 Lidhja e marrëveshjeve të reja
 - 46 Punëtoritë/seminaret
 - 48 Trajnimet orientuese dhe rifreskuese me institucionet partnere financiare
 - 49 Storie suksesi
 - 50 Takimet e Bordit të Drejtorëve dhe të komiteteve përkatëse
-

52 PJESA VI - PASQYRAT FINANCIARE TË AUDITUARA

PJESA I

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

FJALA E KRYESUESIT TË BORDIT DHE DREJTORIT MENAXHUES

Vitin e kaluar, kur filluam të shkruajmë fjalën hyrëse për raportin vjetor të vitit 2019, e gjithë vëmendja dhe fokusi institucional ishte në situatën e krijuar nga pandemia e COVID-19. Fakti që gjenerata jonë ballafaqohej për herë të parë me një situatë unike, të pa përjetuar më herët, po krijonte pasiguri dhe shumë të panjohura, athua çfarë do të sillte e ardhmja. Së këndejmi, edhe fjala hyrëse në raportin vjetor të një viti më herët, reflektonte mishërim me shoqërinë tonë, analizë e kapaciteteve institucionale brenda FKKG-së për t'u përballur me goditjet që do të mund t'i sillte kjo krizë, si dhe empati njëherazi edhe përgjegjësi institucionale se si ne si FKKG, do të mund të mbështesnim ndërmarrjet private në Kosovë në luftimin dhe minimizimin e pasojave nga kriza e pandemisë COVID-19.

Tani një vit më vonë, kur hedhim një shikim në retrospektivë dhe vlerësojmë se si institucioni ynë iu përshtat realitetit të ri, nuk mund të themi asgjë më pak përveç që ndihemi krenarë me atë që ne, së bashku me donatorët tanë, kemi ndërtuar dhe krijuar, për një periudhë kaq të shkurtër kohore. Ishte një test shumë i rëndësishëm për të vlerësuar mbi çfarë baze profesionale dhe kulture institucionale është ndërtuar institucioni i FKKG-së, si njëri nga institucionet më të reja në shtetin e Kosovës. Gjatë vitit të kaluar, FKKG përveç që dëshmoi se është institucion mirë i konsoliduar dhe i gatshëm të përballojë edhe situatat më ekstreme dhe më të paparashikueshme, siç ishte pandemia e COVID-19, edhe një herë tregoi aftësi për të balancuar pjekurinë institucionale me të qenit pro-aktiv, në mënyrë që të ruajë qëndrueshmërinë financiare të institucionit, ndërsa në të njëjtën kohë të arrijë t'i përgjigjet nevojave të reja të sektorit privat dhe atij bankar, në procesin e mbështetjes së ndërmjetësimit financiar. Jo rastësisht gjatë kësaj periudhe, FKKG ishte partner i preferuar dhe i besueshëm i sektorit bankar, i autoriteteve vendore, si dhe i donatorëve ndërkombëtarë, në adresimin e njërit nga problemet më akute që do të mund të lindte nga kriza e shkaktuar nga pandemia, gjegjësisht zbehja e mundësive për financim të ndërmarrjeve private në Kosovë, që si rrjedhojë do të përkeqësonte likuiditetin në treg dhe do të shumëfishonte dëmet në sektorin privat. Gjatë vitit 2020, ne vazhduam, përkundër krizës shëndetësore dhe ekonomike, pa asnjë

mëdyshje, mu atëherë kur perceptimi i riskut kreditor në treg vlerësohej si shumë i lartë, të mbajmë hapur dy dritaret garantuese ekzistuese, atë të rregullt dhe dritaren e agros. Ishte ky një mesazh që reflektonte konfidencë dhe siguri për partnerët tanë, që më pastaj u vlerësua me shumë pozitivitet nga komuniteti bankar dhe ai i biznesit privat. Vetëm gjatë periudhës së pandemisë, kur qeveria kishte futur shumë kufizime lidhur me lëvizjen e lirë dhe limitim të aktiviteteve afariste në shumicën e sektorëve ekonomikë, me qëllim të frenimit të shpërndarjes së virusit, përmes dritareve garantuese të FKKG-së u garantuan 1,200 kredi, në vlerë prej 40 milionë euro. Për më shumë, FKKG luajti rol thelbësor gjatë të gjitha fazave të dizajnit dhe implementimit të programit të rimëkëmbjes ekonomike, program ky që arriti kulmin me lansimin e pesë dritareve garantuese, e që kishte për qëllim rritjen e konfidencës në kreditim, duke rritur mbulueshmërinë e riskut kreditor deri në 80%, për sektorë të caktuar ekonomikë. Ishte kjo një maratonë e përpjekjeve dhe shumë analizave të brendshme të kolegëve në FKKG, së bashku me përfaqësues të institucioneve të Kosovës, donatorë ndërkombëtarë dhe banka partnere, për t'ia përshtatur sa më mirë kushtet e skemave tona garantuese rrethanave të reja të krijuara në treg, e që para së gjithash kërkonte adaptim të infrastrukturës ligjore dhe rrjedhimisht edhe adaptim të kushteve në kuadër të skemës garantuese.

Mbështetja nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe donatorët tanë ndërkombëtarë kryesisht nga USAID dhe KfW, nuk mungoi as gjatë kësaj periudhe. Posaçërisht vlen të përmendet vazhdimi i kontributit në kapital nga KfW, në vlerë prej 11.5 milionë, nga të cilat 6.5 milionë u dedikuan për të fuqizuar dritaren ekzistuese të agros, dhe 5.0 milionë për të mbështetur programin e rimëkëmbjes ekonomike. Po ashtu, viti i kaluar shënoi edhe finalizimin e marrëveshjes me Bankën Botërore për Projektin e Fuqizimit të Sektorit Financiar në Kosovë, projekt ky me kohëzgjatje katërvjeçare që përfshin në vete rritjen e kapitalit të FKKG-së për 21.4 milionë, si dhe asistencën teknike të destinuar për fuqizimin e kapaciteteve dhe proceseve të brendshme të institucionit, posaçërisht për ndërtimin e Sistemit për Menaxhimin Mjedisor dhe Social, avancimin e komunikimit me publikun, si dhe avancimin e

praktikave më të mira të menaxhimit financiar dhe riskut kreditor në institucion. Me këto kontribute, vlera e kapitalit të FK GK-së gjatë vitit të kaluar është dyfishuar nga 16.7 milionë euro në 49.6 milionë euro në fund të vitit 2020, fakt ky shumë i rëndësishëm pasi që shënjon rritjen e potencialit garantues të institucionit dhe rrjedhimisht edhe ndikimin në ndërmjetësimin financiar.

Ndërtimi i një institucioni që respekton parimet bazë të përgjegjësisë mjedisore dhe sociale, ishte dhe vazhdon të mbetet një nga objektivat e strategjisë afatgjate institucionale. Se si mund të menaxhohet dhe zbutet ndikimi mjedisor dhe social i aktiviteteve tona garantuese të kredive për NMVM-të, ishte preokupim i vazhdueshëm institucional që nga fillimi, mirëpo kjo mori rëndësi më të madhe posaçërisht gjatë dy viteve të fundit, kur skema garantuese e FK GK-së filloi të rritej ndjeshëm dhe tanimë kishte rol të theksuar në mbështetjen e aktivitetit kreditor brenda sektorit bankar. Prandaj gjatë vitit të kaluar, me mbështetje nga projekti i Bankës Botërore dhe KfW, FK GK punoi ngushtë me institucionet financiare (IF) partnere për të ndërtuar një Sistem të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS), përgjatë të gjitha hallkave në zinxhirin e kreditimit.

Në anën tjetër, projekti për ndërtimin e dritares së energjisë me Fondacionin e Mijëvjeçarit të Kosovës, një partneritet ky shumë i rëndësishëm që synon t'i ofrojë FK GK-së dhe sektorit bankar asistencë teknike për të krijuar një mjedis në të cilin kreditorët mund të fillojnë t'u japin kredi investitorëve privatë për prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme, gjegjësisht energjisë solare, ka vazhduar dhe është në rrugë të mirë që një dritare e tillë të jetë pjesë e programit për rimëkëmbje ekonomike.

Vlen të përmendet që FK GK gjatë vitit të kaluar arriti të finalizojë AgroSoft-in, një platformë softuerike që ndihmon procesin e vlerësimit të riskut kreditor për aktivitetet në sektorin e bujqësisë. Kjo platformë e krijuar falë asistencës teknike nga KfW dhe e zhvilluar nga personeli i FK GK-së në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, sot është një mjet shumë praktik në duart e analistëve kreditorë të bankave partnere për të vlerësuar aftësinë kreditore të klientëve në sektorin e bujqësisë.

FK GK vazhdon të mbetet njëri nga depozituesit më të mëdhenj në sektorin bankar në Kosovë. Për të pestin vit me radhë, strategjia e investimeve e FK GK-së vazhdon të kanalizohet në formë të depozitave afatshkurtra dhe afatmesme në bankat vendore. Kjo qasje institucionale e pasqyron besimin e strukturave qeverisëse të FK GK-së në sektorin bankar të vendit tonë dhe, njëherazi, duke e rritur likuiditetin në treg, ofron më shumë mundësi për ta rritur kapacitetin kreditues të bankave lokale.

Ndonëse kemi lënë prapa një vit të vështirë me shumë sfida, ne konsiderojmë që kjo ka rritur pjekurinë dhe stabilitetin tonë institucional – vlerësojmë që tani jemi më të fortë sesa një vit më herët. Sidoqoftë, edhe më tutje vazhdojmë të jemi të kujdesshëm dhe të vetëdijshëm që pandemia ende nuk ka kaluar, ndërsa inercia e krizës nga viti i kaluar gjithsesi do të reflektojë këtë vit. Pasojat do të jenë evidente, ndërsa shkalla e impaktit të tyre do të jetë edhe një tregues i cilësisë dhe përshtatshmërisë së programit të rimëkëmbjes ekonomike, së bashku me të gjitha masat tjera të ndërmarra nga rregullatori dhe autoritetet lokale. Në bashkëpunim me QRK-në dhe donatorët tanë, FK GK do të vazhdojë të implementojë pakon e rimëkëmbjes gjatë tërë vitit 2021, ndërsa në të njëjtë kohë do të jemi proaktivë dhe të hapur ndaj iniciativave të reja që synojnë të mbështesin sektorin privat edhe në fazat tjera të pas rimëkëmbjes ekonomike. Kjo rrjedh nga ndjenja e përgjegjësisë morale e mishëruar dhe e kultivuar në kulturën dhe misionin e institucionit tonë, e pranuar me vullnet nga i gjithë stafi dhe bordi i FK GK-së, me të vetmin qëllim që nga kriza të dalim edhe më të fuqishëm.

Në fund, na lejoni që në emër të Bordit të Drejtorëve dhe stafit të FK GK-së t'i shprehim falënderim donatorëve tanë ndërkombëtarë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për mbështetjen e vazhdueshme dhënë FK GK-së. I jemi mirënjohës edhe të gjithë aktorëve të tjerë, para së gjithash Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) dhe institucioneve partnere financiare për bashkëpunimin e vazhdueshëm. Në të njëjtën kohë, edhe pse në horizont kanë filluar të duken shenjat e para që pandemia është nga fundi, të gjithëve ju dëshirojmë shëndet me porosinë që të gjithë duhet të vazhdojmë të jemi të kujdesshëm, në mënyrë që metrat e fundit të këtij rrugëtimit të mbesin metra dhe mos të shndërrohen në kilometra.

RINOR GJONBALAJ

Kryesues i Bordit të Drejtorëve

BESNIK BERISHA

Drejtor Menaxhues

AKRONIMET

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BD	Bordi i Drejtorëve
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
EBRD	Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim
EIB	Banka Evropiane për Investime
EIF	Fondi Evropian për Investime
FKGK	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
IF	Institucioni Financiar
IFC	Korporata Ndërkombëtare Financiare
IFJB	Institucionet Financiare Jo-Bankare
IPF	Institucionet Partnere Financiare
IMF	Institucionet Mikrofinanciare
KFW	Banka Gjermane për Zhvillim
KJP	Kreditë Jo-Performuese
KMR	Komiteti për Menaxhimin e Riskut
KA	Komiteti i Auditimit
MF	Ministria e Financave
MTI	Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë
NMVM	Ndërmarrje Mikro, të Vogla dhe të Mesme
PFSF	Projekti për Forcimin e Sektorit Financiar
PMMS	Politika e Menaxhimit Mjedisor dhe Social
QRK	Qeveria e Republikës së Kosovës
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
SMI	Sistemi për Menaxhimin e Informatave
SMMS	Sistemi i Menaxhimit Mjedisor dhe Social
SHBK	Shoqata e Bankave të Kosovës
USAID	Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar

PËRMBLEDHJE E TREGUESVE FINANCIARË

TREGUESIT KRYESORË FINANCIARË	DHJETOR 2019	DHJETOR 2020
KAPITALI	16,286,801	49,747,447
Potenciali garantues	94,007,608	182,897,947
Limitet e alokuara	70,400,000	83,350,000
Shkalla e shfrytëzimit të limiteve nga IF-të partnere	62.3%	67.1%
BILANCI I GARANCIVE	43,885,949	55,997,787
Nr. i kredive aktive të garantuara	3,120	4,248
Nr. i IF-ve partnere	8	8
Mesatarja e garancive	18,558	18,151
Mesatarja e maturitetit	36	36
KJP (në %)	1.29 %	1.55%
Mbulueshmëria e KJP-së me provizionim (në %)	122.0 %	166%
KAPITALI I INVESTUAR	16,620,045	23,778,921

Vlerat monetare janë në euro



PJESA II

PROFILI I INSTITUCIONIT

THEMELIMI I FKGGK-SË DHE STATUSI I SAJ

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore është institucion i pavarur dhe i qëndrueshëm, i cili u lëshon garanci institucioneve financiare për të mbuluar riskun për kreditë e NMVM-ve. FKGGK është themeluar në janar të vitit 2016, duke u bazuar në Ligjin nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. Ligji themelues i FKGGK-së u sponsorizua nga MTI-ja, me përkrahje të USAID-it përmes Programit për Fuqizimin e Mbështetjes Kreditore dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW). Ligji për themelimin e FKGGK-së ka hyrë në fuqi më 23 janar 2016.

MISIONI

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore është një subjekt i pavarur juridik me karakter zhvillimor, i cili ofron garanci kreditore për NMVM-të, duke ndarë riskun kreditor me institucionet financiare. Përmes garantimit të portofolit kreditor të institucioneve financiare ne synojmë rritjen e qasjes në financa për NMVM-të, mbështetjen e zhvillimit të ndërmarrësisë, mbështetjen e prodhimit vendor dhe të atyre shërbimeve të cilat sjellin vlerë të shtuar, krijojnë vende të reja të punës dhe mbështesin zhvillimin e përgjithshëm ekonomik.

Ne jemi të përkushtuar ndaj menaxhimit të qëndrueshëm korporativ dhe ndaj përgjegjësisë sociale që e shoqëron atë. Duke i koordinuar aktivitetet me partnerët tanë: donatorët, institucionet financiare dhe rregullatorët lokalë, ne mundohemi t'u shërbejmë interesave afatgjate ekonomike të vendit, komunitetit të biznesit dhe shoqërisë sonë në përgjithësi.





VLERAT INSTITUCIONALE

Vlerat institucionale të FK GK-së, të cilat frymojnë brenda institucionit, si dhe shërbejnë për ndërtimin e praktikave të përditshme në punë janë udhërrëfyese për të siguruar që aktivitetet tona afariste të kenë një nivel të lartë të llogaridhënies dhe të jenë në përputhje me standardet më të larta etike dhe morale.

TRANSPARENCA

Duke qenë institucion me interes publik, FK GK e konsideron si shumë të rëndësishme shpalosjen e informacionit lidhur me praktikën e punës, politikat dhe rezultatet financiare e operative me partnerët, me palët e tjera të interesit, si dhe me publikun e gjerë.

PARTNERITETI DHE BASHKËPUNIMI

Ndërtimi i marrëdhënieve të shëndosha, duke u bazuar në transparencë dhe në llogaridhënie në raport me partnerët tanë, ndihmon në arritjen e objektivave të përbashkëta, në ndërtimin e besueshmërisë dhe respektit të ndërsjellë.

OBJEKTIVITETI DHE PAVARËSIA NË VENDIMMARRJE

FK GK ruan objektivitetin dhe pavarësinë në vendimarrje, duke u bazuar në arsyen e shëndoshë dhe në parime të shëndosha, duke nxitur zhvillimin e mëtutjeshëm të sektorit financiar.

PËRKUSHTIMI

Punonjësit e FK GK-së me përkushtim dhe me profesionalizëm mundohen të realizojnë misionin dhe objektivat e saj, duke besuar në rolin dhe në ndikimin pozitiv që ka institucioni në zhvillimin e shëndoshë ekonomik.

PUNA EKIPORE DHE PROFESIONALIZIMI NË PUNË

FK GK ka një ekip ekspertësh, të cilët bashkëpunojnë mbi bazat e respektit të ndërsjellë. Puna ekipore për zgjidhjen e problemeve dhe të iniciativave, komunikimi i hapur dhe ndarja e përvojave profesionale në mes vete janë bazamenti i suksesit të FK GK-së.

Integriteti dhe dinjiteti personal janë vlera që e përcjellin secilin punëtor në vazhden e realizimit të detyrave dhe të iniciativave në punë, pa bërë asnjë kompromis në këto parime.



PJESA III

QEVERISJA KORPORATIVE

BORDI I DREJTORËVE DHE PERSONELI

FKGK qeveriset nga një Bord i Drejtorëve i përbërë nga shtatë (7) anëtarë:

- A. Një (1) anëtar sipas detyrës zyrtare, i emëruar nga Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë e Republikës së Kosovës;
- B. Një (1) anëtar sipas detyrës zyrtare, i emëruar nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës;
- C. Katër (4) anëtarë të pavarur, të emëruar nga donatorët; dhe
- D. Drejtori menaxhues i FKGK-së sipas detyrës zyrtare.

ANËTARËT E BORDIT TË DREJTORËVE TË FKGK-SË NË VITIN 2020:



RINOR GJONBALAJ

Kryesues i Bordit dhe
Kryesues i Komitetit të Riskut



ARTA HOXHA

Anëtare e pavarur e Bordit dhe
Kryesuese e Komitetit të Auditimit



BESNIK BERISHA

Drejtor menaxhues i FKGK-së
dhe anëtar i Bordit



KRESHNIK KURTISHI

Anëtar i pavarur i Bordit



MELIH CADIRCI

Anëtar i pavarur i Bordit



NOL BUZHALA

Anëtar i Bordit sipas detyrës
zyrtare - Ministria e Tregtisë
dhe Industrisë



SALVADOR ELMAZI

Anëtar i Bordit sipas detyrës
zyrtare - Ministria e Financave

PERSONELI AKTUAL

PERSONELI I FKKG-SË NË 2020:



Nga e majta në të djathtë:

BESNIK BERISHA

Drejtor menaxhues;

KASTRIOT KËPUSKA

Agro ekspert;

VJOSA BALAJ

Menaxhere e lartë e financave
dhe e administratës;

VERË KADRIU

Asistente për administratë dhe përkthime;

TEA BLAKAJ HOXHA¹

Zyrtare e lartë ligjore dhe sekretare e
Bordit të Drejtorëve;

ALBAN KASTRATI

Menaxher i lartë i riskut;

NORA ARIFI

Menaxhere e lartë e garancive;

BURBUQE GURI

Asistente e financave dhe e administratës;

BLERT GJINOLLI

Ekspert mjedisor dhe social;


JETON REXHEPI

Ekspert i riskut kreditor për financim të
projekteve.

¹ Deri më 31 mars 2020, z. Partin Pruthi ishte Zyrtar i lartë ligjor dhe sekretar i Bordit të Drejtorëve. Këtë detyrë në gusht të 2020 e mori znj. Tea Blakaj Hoxha e cila veproi në FKKG në këtë cilësi deri në dhjetor 2020

STRUKTURA ORGANIZATIVE

FKGK



Numri i personelit të rregullt të FKGK-së është gjashtë, ndërsa katër pjesëtarë të stafit janë të angazhuar në implementimin e projekteve nga donatorët si vijon:

AGRO EKSPERTI – i angazhuar në zhvillimin e Agro Dritares, projekt i mbështetur nga KFW;

EKSPERTI I RISKUT KREDITOR PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE – i angazhuar në zhvillimin dhe implementimin e dritares së energjisë, projekt i mbështetur nga MCC/MFK;

ASISTENTJA E FINANCEVE DHE E ADMINISTRATËS – e angazhuar në zhvillimin dhe implementimin e dritares së energjisë, projekt i mbështetur nga MCC/MFK

EKSPERTI MJEDISOR – përgjegjës për implementimin e SMMS, i angazhuar në kuadër të PFSF-së me BB-në.

KOMITETET

KOMITETI I MENAXHIMIT TË RISKUT

Komiteti i Menaxhimit të Riskut është themeluar në bazë të Ligjit për FKGK-në. Komiteti i Menaxhimit të Riskut ndihmon Bordin e Drejtorëve me fokus të specializuar në fushën e menaxhimit të riskut. Komiteti i Menaxhimit të Riskut mbledhet së paku në bazë tremujore dhe përbëhet nga tre (3) anëtarë të Bordit, përderisa menaxheri i lartë i riskut është anëtar i përhershëm i Komitetit.

Si i tillë, Komiteti shqyrton politikat e riskut kreditor dhe operativ, mbikëqyr zhvillimet e portofolit të garantuar dhe siguron që profili i riskut kreditor është në përputhshmëri me politikat kreditore, me ligjet dhe me rregulloret e zbatueshme.

KOMITETI I AUDITIMIT

Komiteti i Auditimit është themeluar në bazë të Ligjit për FKGK-në. Komiteti i Auditimit përbëhet nga katër (4) anëtarë të Bordit dhe takimet mbahen në bazë tremujore.

Ky Komitet është përgjegjës për t'i dhënë rekomandime Bordit të Drejtorëve lidhur me menaxhimin e riskut, kontrollin e brendshëm, pasqyrat financiare, kërkesat e pajtueshmërisë, auditimin e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe për funksione të tjera relevante të qeverisjes së FKGK-së. Përveç kësaj, Komiteti i Auditimit rishikon kontrollet e brendshme financiare, operative dhe administrative.



BASHKËPUNËTORËT E FKGGK-SË

Për t'i arritur objektivat dhe synimet e veta, FKGGK bashkëpunon me institucionet financiare (bankat, IMF-të, IBBF-të), me donatorët, me Qeverinë e Republikës së Kosovës, me Bankën Qendrore të Kosovës dhe me Komunitetin e NMVM-ve.

DONATORËT

- Qeveria e Republikës së Kosovës
- Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)
- Banka Gjermane për Zhvillim (KfW)

BASHKËPUNËTORËT

- Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA), e përfaqësuar nga Ambasada Suedeze
- Banka Botërore
- Fondi Evropian për Investime (EIF)
- Fondacioni i Mijëvjeçarit të Kosovës

INSTITUCIONET PARTNERE FINANCIARE

- | | |
|----------------------------|-----------------------------|
| ▪ Banka Ekonomike | ▪ ProCredit Bank |
| ▪ Banka Kombëtare Tregtare | ▪ Raiffeisen Bank |
| ▪ Banka për Biznes | ▪ TEB |
| ▪ NLB Banka | ▪ Raiffeisen Leasing Kosovë |



PJESA IV


PERFORMANCA E FKGGK-së

ZHVILLIMI I PORTOFOLIT TË GARANCIVE


VAZHDIMËSI E RITJES SË SHPEJTË DHE ME CILËSI TË LARTË

Viti 2020 ishte një vit sa sfidues po aq i suksesshëm për FKGK-në, e cila vazhdoi të ofrojë garanci kreditore për NMVM-të, duke ndarë riskun kreditor me institucionet financiare në një nivel edhe më të lartë se vitet e shkuara. Përgjatë gjithë periudhës së pandemisë, FKGK ka vazhduar të mbajë hapur dritaret ekzistuese garantuese, përkundër rritjes së perceptimit të riskut në treg dhe paparashikueshmërisë së rrjedhës së ngjarjeve në mbarë botën, mirëpo posaçërisht në vendin tonë.

Gjatë vitit 2020, në sajë të ndërmjetësimit të FKGK-së u mundësua huadhënie në sektor me vlerë prej 71.78 milionë euro, të shpërndara në 2,030 kredi për 1,821 NMVM, të mbështetura me garanci në vlerë prej 35.1 milionë euro. Shuma kumulative e kredive të miratuara në fund të vitit arriti vlerën prej 228.9 milionë euro për 5,075 NMVM, e mbështetur me një shumë kumulative të garancive prej 110.7 milionë euro.




Vlera totale e mbetur e portofolit të kredive, në fund të vitit 2020, ishte 115 milionë euro, përderisa vlera totale e mbetur e portofolit të garantuar ishte 55.99 milionë euro.



RRETH 99% E PORTOFOLIT PËRBËHET NGA NDËRMARRJET E VOGLA

Portofoli i garantuar vazhdon të ketë pjesëmarrje më të madhe nga ndërmarrjet mikro dhe të vogla. Përqendrimi i portofolit të garantuar sipas numrit të punëtorëve ishte në segmentin e ndërmarrjeve mikro deri në 9 punëtorë.

PJESËMARRJA E KREDIVE TË GARANTUARA NË SEKTORIN E NDËRMARRJEVE




Një distribuim i tillë i portofolit të garancisë është një reflektim i sektorit privat të vendit tonë, por edhe i orientimit të Institucionit tonë drejt qasjes në financa për këtë segment.

GARANCITË KREDITORE SIPAS SEKTORËVE TË EKONOMISË

Stimulimi i sektorëve që krijojnë vlerë të shtuar për ekonominë si dhe diversifikimi sa më i mirë mbetën ndër objektivat e FKGK-së. Për këtë qëllim, FKGK me ndihmën e donatorëve dhe partnerëve të saj ka punuar në vazhdimësi në ndërtimin e produkteve të cilët do të mbështetin Rimëkëmbjen Ekonomike, me fokus të veçantë drejt forcimit të sektorëve strategjikë.

Viti 2020 ka vazhduar të ndjekë trendin e njëjtë sikurse një vit më parë, duke reflektuar me një gamë të gjerë të sektorëve të ekonomisë si përfutjes të garancive. Një trend i tillë njëherësh paraqet trendin e ekonomisë së vendit tonë.

KREDITË SIPAS SEKTORËVE




Sektori më dominues në portofolin e kredive të garantuara gjatë vitit 2020 ishte ai i tregtisë me pakicë dhe me shumicë me 43%, pasuar nga sektori i shërbimeve me 20%, prodhimi me 17%, ndërtimtaria me 13% dhe bujqësia me 7%. Në krahasim me një vit më parë, kemi një lëvizje të moderuar nëpër sektorë duke vërejtur rritje në sektorin e tregtisë dhe rënie në sektorin e shërbimeve dhe bujqësisë, të cilët ishin të ndikuar nga mbyllja mu në stinën e investimeve në këta sektor, për arsye të situatës së shkaktuar nga COVID-19.

Ndërsa sektori i bujqësisë ka vazhduar të ketë pjesëmarrje të ulët me diku 2.8% gjithsej në sektorin bankar, kjo pjesëmarrje gjithsej në portofolin aktiv të FKKG-së në fund të vitit 2020 ishte 9.6%.

Stimulimi i sektorëve që krijojnë vlerë të shtuar për ekonominë, siç janë bujqësia, prodhimi dhe sektori i shërbimeve, është një nga objektivat tanë, prandaj së bashku me partnerët e FKKG-së është duke u punuar në drejtim të forcimit të këtyre dhe sektorëve të tjerë më pak të shërbyer duke konsideruar se këta janë forca lëvizëse e ekonomisë dhe kontribuojnë në rritjen e punësimit dhe në ngritjen e mirëqenies sociale në përgjithësi.

INVESTIMET PËR KAPITAL QARKULLUES DHE QËLLIME MIKSE² ME DOMINIM MË TË LARTË

Kërkesa për kredi dhe lloji i investimit na ndihmojnë të kuptojmë zhvillimet ekonomike gjatë periudhës së pandemisë.



Në vitin 2020, 13% e kredive të aprovuara ishin investuar në pajisje (makineri të prodhimit, pajisje bujqësore, pajisje të tjera); 9% në tokë, në ndërtim ose në rinovim; 39% për kapital qarkullues dhe 39% në të tjera.


Kërkesa e tillë për kredi afatshkurta, mbitërheqje e linja kreditore na dha indikacione për presionin e fluksit të parase (cash flow) gjatë 2020.

² Në praktikë, nëse një huadhënie ka për qëllim investime që bëhen njëkohësisht; në kapital punues, asete fikse, renovim apo edhe ndërtim, atëherë kjo shënohet si huadhënie me destinim për qëllime mikse.

SHFRYTËZIMI I GARANCIVE NË RAJONE TË NDRYSHME

Shfrytëzimi i garancive në rajone të ndryshme edhe në vitin 2020 ndoqi trendin e viteve paraprahe. Rajoni i Prishtinës kishte pjesëmarrjen më të madhe në portofolin e kredive të vëna nën garanci me një pjesëmarrje prej 57%.

Një shpërndarje e tillë e portofolit konsiderohet të jetë në linjë me shpërndarjen e portofolit kreditor të sektorit bankar në rajonet përkatëse.



GARANTIMI I AGRO FINANCIMIT PËRMES DRITARES AGRO


Krahas sektorëve tjerë, edhe sektori i bujqësisë në përgjithësi u ndikua nga pandemia e COVID-19. Më të prekur ishin sidomos nën-sektorët e bujqësisë të cilët ishin të lidhur më shumë me sektorin e gastronomisë, si prodhimi i perimeve ose industria e mishit, përderisa prodhimi i frutave, kryesisht atyre të imta e sidomos mjedrave, shënoi një rritje të theksuar, sepse fermerët kishin më tepër kohë në dispozicion për vjelje dhe kërkesa për produkte të tilla të freskëta ishte rritur dukshëm gjatë pandemisë.

Përkundër mundësisë së dhënë për ri-strukturim të agro kredive problematike për t'u kthyer, prapë se prapë kjo mundësi u shfrytëzua nga një numër i vogël i klientëve të këtij sektori. Garantimi i sektorit të bujqësisë gjatë vitit 2020 ishte për rreth 25% më pak krahasuar me vitin paraprak. Kjo rënie i atribuohet kryesisht tremujorit të dytë të vitit 2020, ku paqartësitë rreth ecurisë dhe kohëzgjatjes së pandemisë ndikuan dukshëm në hezitimin e fermerëve për të investuar në këtë sektor.

Financimi i sektorit të bujqësisë nga ana e bankave vazhdon të jetë i ulët në raport me financimin e sektorëve tjerë. Në fund të vitit 2020, ky sektor morri pjesë me 2.8 % të kredive aktive të bankave, gjë që paraqet ulje për rreth 1% krahasuar me vitin paraprak. Ulja e pjesëmarrjes së financimit vjen edhe si rrjedhojë e rritjes së pjesëmarrjes në sektorët tjerë, kryesisht ndërtimtarisë.

FKGK e konsideron shumë të rëndësishëm financimin dhe garantimin e sektorit të bujqësisë, duke e parë atë si një sektor që luan rol të theksuar pozitiv në gjenerimin e punësimit dhe uljen e shkallës së lartë të papunësisë. Aktivitetet në këtë sektor konsiderohen gjithashtu si një mundësi e mirë e gjenerimit të të hyrave, si nga projektet e mëdha, po ashtu edhe nga ato projekte të investimeve të cilat kanë nevojë për investime më të vogla. Këto investime, po ashtu kanë si rezultat final edhe punësimin dhe zgjidhjen e çështjeve sociale për shumë familje, sidomos atyre në zonat rurale të vendit.

FKGK përmes Dritares Agro, deri në fund të vitit 2020 ka mundur garantimin e kredive bujqësore në vlerë mbi 16.6 milionë euro. Përkrahja që ky sektor gëzon nga ana e FKGK-së është forcuar akoma më shumë, kur gjatë periudhës së pandemisë në muajin prill 2020, Banka Gjermane për Zhvillim ndau kapital shtesë në shumë prej 6.5 milionë euro për të përkrahur dhe garantuar financimet në këtë sektor. Kjo ndihmesë e taksapaguesve gjermanë për fermerët dhe agrobizneset kosovare, aktive në këtë sektor, duke qenë e para e formatit "pa tokje duarsh", ishte e mirëseardhur aq më tepër duke pasur parasysh krizën shëndetësore globale me të cilën ballafaqohej çdo fermer ndërmarrës.





SHTUESHMËRIA

Shtueshmëria është arsyeja thelbësore për themelimin e FK GK-së. Kjo do të thotë se bankat, Institucionet Mikro Financiare ose Institucionet Financiare Jo-Bankare nuk do t'i jepnin një NMVM-je kredi pa garancinë e dhënë, duke shtuar kështu një klient të ri dhe duke kontribuar në rritjen ekonomike.

Për të vërejtur këtë impakt, FK GK ka analizuar treguesit e ndërlidhur me shtueshmërinë financiare duke reflektuar në të dhënat e siguruara nga Regjistri Kreditor i Kosovës dhe të dhënat e siguruara nga Sistemi për Menaxhimin e Informatave (SMI) të FK GK-së. Me këtë rast u analizuan dhe u krahasuan kreditë e lejuara në sektor gjatë 2020 me kreditë e lejuara në sektor por të garantuara nga FK GK. Rezultatet e monitorimit të këtyre treguesve na treguan se në sajë të aktivitetit të FK GK-së në përgjithësi është rritur qasja në financa dhe janë relaksuar standardet e huadhënies.




PJESËMARRJA E KREDIVE TË GARANTUARA NË SEKTORIN BANKAR

Ky tregues edhe në këtë vit tregon rritje të pjesëmarrjes së kredive të garantuara në sektorin bankar. Sa më e madhe të jetë pjesëmarrja, aq më i madh është ndikimi i FK GK-së në aktivitetin e huadhënies në sektorin bankar, e që për NMVM-të nënkupton qasje më e madhe në financa. Në vitin 2020, kjo pjesëmarrje në kategorinë e kredive deri në 100,000 euro ishte 17%, ndërsa vetëm në kategorinë 25,000-50,000 euro ishte 21%. Arsyeja

e reflektimit në kategorinë deri në 100,000 euro është për shkak se profili i klientëve në portofolin e FK GK-së i takon këtij segmenti në treg. Ky tregues shënoi një rënie të lehtë prej 1%, krahasuar me vitin 2019, kur pjesëmarrja ishte 18%. Ndonëse kishim një rënie të tillë, konsiderojmë që skema e garancisë kreditore e FK GK-së ka shtuar tutje ndikimin pozitiv në ndërmjetësimin financiar.

PJESËMARRJA E FK GK-SË NË SEKTOR (vlerë financiare)




MESATARJA E MATURITETIT TË KREDISË

Portofoli i garantuar gjatë viti 2020 vazhdoi të përbëhej nga kredi afatmesme me një mesatare prej 36 muajsh. Mesatarja e maturitetit të kredisë si tregues i shtueshmërisë financiare në këtë vit tregoi përsëri rritje të maturitetit të kredive të garantuara krahasuar me kreditë e pagantuara. Sa më i gjatë maturiteti, aq më të mira do të jenë kushtet e financimit për huamarrësit, ndërsa risku për huadhënësit do të jetë më i lartë.

Kohëzgjatja mesatare e kredive të garantuara deri në 100,000 euro ishte 37 muaj ose për 28% më e madhe se mesatarja e kredive të pagantuara. Ky tregues gjatë viti 2020 sikur edhe në vitin 2019 rezultoi në standarde më të relaksuara të riskut nga ana e IPF-ve, ndaj edhe kushte më të mira të huamarrjes për NMVM-të e që për NMVM-në çdo rritje e maturitetit do të rritë kapacitetin e huamarrësit për kompletuar investimin e planifikuar.

MESATARJA E MATURITETIT TË KREDISË




MBULUESHMËRIA ME KOLATERAL

Kolaterali, shumë shpesh është një nga arsyet e refuzimit të aplikacionit të kredisë ose një nga arsyet e zvogëlimit të shumës së kredisë së kërkuar. Ndaj, në rastin e impaktit të skemës së garancisë, kërkesa më e ulët për kolateral, nënkupton parasëgjithash përfshirje financiare,

kushte më të mira të huadhënies për klientët, kohë më të shkurtër për përpunimin e aplikacionit për kredi dhe kosto më të ulët të huamarrjes. Në vitin 2020, skema e garancisë së FKGK-së rezultoi me një ndikim pozitiv, duke zvogëluar kërkesën për kolateral për 71%.

DIFERENCA E KËRKESËS PËR KOLATERAL




KLIENTËT E RINJ / PËRFSHIRJA FINANCIARE

Pjesëmarrja më e lartë e kësaj kategorie të klientëve (të cilët nuk kanë marrë kredia njëherë) në portofolin e përgjithshëm të klientëve të kredisë, nënkupton perceptim më të ulët të riskut nga bankat, në lidhje me ndërmarrjet e krijuara rishtazi, pra një nivel më të lartë të përfshirjes financiare për bizneset e reja. Pjesëmarrja e kredive të garantuara për biznese të reja pa përvojë të mëhershme të huamarrjes në

vitin 2020 në kategorinë e kredive deri në 100,000 euro ishte 26%, ose 93% më e lartë se pjesëmarrja e kredive të pa garantuara e të njëjtit segment. Ky raport pasqyron ndikimin e FK GK-së në përfshirjen financiare të sektorit privat pa eksperiencë të mëhershme kreditore, ndaj edhe ndikimin pozitiv në sektorin financiar dhe në ekonomi në përgjithësi.

KREDITË E REJA




SHUMË MESATARE MË E LARTË E KREDIVE TË GARANTUARA

Portofoli i FK GK-së edhe në fund të viti 2020 ishte i populluar nga ndërmarrje të kategorisë së vogël, me vlerë kreditore mesatare prej 30,000 euro. Kjo vlerë përputhet me kategorinë e vogël të ndërmarrjeve të cilat kanë mungesë të kolateralit, andaj edhe me nevojën për mbështetje financiare, por edhe me kërkesën gjatë këtij viti e cila ishte kryesisht për kapital qarkullues. Po ashtu, ky vit rezultoi me shumë mesatare më të madhe të

kredive të garantuara për 29% në krahasim me kreditë e pa garantuara në kategorinë e kredive deri në 100,000 euro. Ngritja e shumës mesatare të kredisë përmes ndërmjetësimit të FK GK-së për këtë kategori, reflekton në ndikimin e skemës garantuese në standarde më të mira të huadhënies nga ana e bankave gjatë procesit të miratimit të kredisë edhe për NMVM-të e financuara për herë të parë në sektorin bankar.

MESATARJA E KREDIVE



PJESËMARRJA E BIZNESEVE TË GARANTUARA NË RAPORT ME TË GJITHA BIZNESET AKTIVE NË EKONOMINË REALE

Pjesëmarrja e kredive të garantuara nga FK GK për biznese tatimpaguese është një tregues tjetër i rëndësishëm i përfshirjes së NMVM-ve në skemën e garancisë.

Bazuar në informatat që janë ofruar nga Administrata Tatimore e Kosovës, në vitin 2020 kishim përafërsisht 59,863 biznese aktive (biznese tatimpaguese), ndërsa numri i NMVM-ve të cilat përfituan nga garancitë kreditore të FK GK-së deri në 2020 ishte 5,075 biznese, duke e sjellë pjesëmarrjen e NMVM-ve të garantuara në sektorin e NMVM-ve në 8% në fund të vitit 2020. Kjo pjesëmarrje është duke u rritur nga viti në vit, duke e pasqyruar kështu rëndësinë e FK GK-së si dorë e zgjatur për zhvillimin e sektorit të NMVM-ve, si dhe të ekonomisë në përgjithësi.

PJESËMARRJA E VOLUMIT TË KREDIVE AKTIVE TË GARANTUARA NGA FK GK NË BPV

Për të kuptuar rëndësinë që luan instrumenti i garancisë së FK GK-së në ekonominë kombëtare të vendit tonë, kemi llogaritur pjesëmarrjen e volumit të kredive aktive të garantuara nga FK GK në Bruto Produktin Vendor (BPV) deri në fund të vitit 2020. Kjo pjesëmarrje në fund të 2020 ishte 0.82%, duke shënuar rritje në krahasim me 2019 për 33% (në fund të vitit 2019 ky raport ishte 0.62%).


Një rritje e tillë e pjesëmarrjes së volumit të kredive të garantuara në volumen gjithsej të kredive në sektor (kreditë për NMVM-të), si dhe në BPV-në e Kosovës është një sinjal pozitiv drejt ngushtimit të hendekut të kreditimit në raport me BPV-në e vendit tonë.

KREDITË PËR GRATË NË BIZNES

Ky tregues ka të bëjë me përfshirjen e grave pronare të NMVM-ve në procesin e huamarrjes. Gratë marrin pjesë me një shkallë më të ulët të huamarrjes formale në raport me burrat. Pikërisht për këtë arsye, FK GK ka futur në objektivat e veta institucionale, ofrimin e mundësive më të mira për sektorët dhe për kategoritë më pak të shërbyer të ekonomisë dhe të popullsisë, duke përfshirë gratë.

Gjatë vitit 2020, pjesëmarrja e kredive të garantuara për gratë në biznes ishte 15%. Kjo pjesëmarrje vazhdoi të shënojë rritje në krahasim me vitet paraprake. Rritja e pjesëmarrjes është një mesazh që impakti i garancisë kreditore të FK GK-së ka filluar të vërehet edhe në këtë segment të synuar.

PJESËMARRJA E GRAVE PRONARE



MENAXHIMI I RISKUT KREDITOR

Veprimtaria e FK GK-së është e ndërlidhur me marrjen e riskut, përmes garantimit të pjesshëm të kredive për NMVM-të, të cilat janë vlerësuar nga Institucionet Partnere Financiare (IPF). Si rrjedhojë, risku kreditor që buron nga asimetria e informacioneve, mungesa e kolateralit ose nga risqet tjera gjatë kreditimit të NMVM-ve, bëhet po ashtu pjesë e riskut të FK GK-së për kreditë e garantuara. Duke qenë se FK GK nuk merr pjesë në vlerësimin e riskut të kredisë, proceset janë ndërtuar në mënyrë që të sigurojnë menaxhimin e rregullt të riskut përmes mekanizmave të duhur të monitorimit dhe kontrollit "ex-ante" dhe "ex-post". Qasja në menaxhimin e riskut fillon me identifikimin dhe analizimin e risqeve me të cilat përballet FK GK, për të vazhduar me vendosjen e kontrolleve të duhura për menaxhimin dhe zbutjen e riskut e riskut, si dhe me ndërtimin e sistemit adekuat të monitorimit të riskut. Menaxhimi dhe zbutja e riskut në FK GK zhvillohet përmes:

- Përcaktimit të kushteve dhe kriterëve të qarta kualifikuese për IPF-të, për NMVM-të, si dhe për kreditë që kualifikohen;
- Diversifikimit të portofolit, në nivel të:
 - *IPF-ve, përmes ndarjes së limiteve garantuese;*
 - *NMVM-ve, përmes përcaktimit të ekspozimit maksimal garantues;*
- Ri-garantimit të portofolit përmes skemave garantuese nga institucionet kredibile, duke mundësuar ndarjen e riskut për kreditë e garantuara;
- Monitorimit dhe kontrollit të rregullt në nivel të:
 - *Sektorit financiar,*
 - *IPF-ve, si dhe*
 - *Huamarrësve të garantuar.*

AKTIVITETET PËR MENAXHIMIN E RISKUT GJATË VITIT 2020

Në përputhje me politikat dhe proceset e brendshme, FK GK shqyrtoi dhe miratoi kërkesat për rivlerësimin e limiteve të pothuaj të gjitha IPF-ve gjatë vitit 2020, shqyrtoi dhe modifikoi politikat e brendshme në përputhje me modifikimet e bëra në dritaret përkatëse, menaxhoi në mënyrë efektive riskun e perceptuar nga pandemia globale e COVID-19. Përveç kësaj, gjatë vitit të kaluar FK GK vazhdoi praktikën e mbledhjeve të rregullta mujore, ku analizohen trendet në sektorin bankar në përgjithësi dhe në veçanti për secilin IPF, si dhe analizohet zhvillimi i portofolit të garantuar.

Brenda kapaciteteve ekzistuese, FK GK vazhdoi rritjen e limiteve garantuese ndaj IPF-ve, duke i shtuar limitet garantuese për pothuajse 15 milionë euro gjatë vitit 2020, duke ngritur limitet e përgjithshme të ndara ndaj IPF-të në 83.35 milionë euro. Gjatë vitit 2020, FK GK vijoi shfrytëzimin e skemës ri-garantuese COSME (program i EIF-së) që ofron mundësinë e ndarjes së riskut përmes mbulimit me 50% të kredive të garantuara nga FK GK që kualifikohen për programin COSME.

Skema ri-garantuese ka mundësuar për FK GK-në ndarjen e pjesshme të riskut kreditor, rritjen e kapacitetit garantues, uljen e shpenzimeve të provizionimit, por edhe uljen e tarifave për kreditë që kualifikohen për skemën COSME.

MENAXHIMI I RISKUT NGA SITUATA E KRIJUAR NGA COVID-19

Situata ekonomike në vitin 2020 u përkeqësua ndjeshëm për shkak të pandemisë së COVID-19. Ndërsa fazat fillestare të kësaj krize u përqendruan në përpjekjet që të kuptohet sa më mirë sëmundja, në mënyrë që të ofrohet një kundërpërgjigje sa më e mirë, masat e ndërmarra për të frenuar shpërndarjen e pandemisë së COVID-19 detyrimisht e drejtuan ekonominë drejt krizës dhe recesionit ekonomik. Në këtë kohë pasigurie, fokusi i FKGK-së ishte në menaxhimin sa më efektiv të riskut nga situata e krijuar, por njëkohësisht FKGK ishte e vendosur që të ndihmojë vazhdimin dhe nxitjen e kreditimit nga IPF-të, në mënyrë që të zbuten ose mos të ashpërsohen efektet e krizës.

Masat e ndërmarra nga gjithë aktorët ndikuan në sektorin financiar, duke zbutur efektet dhe pasojat e krizës në performancën e sektorit financiar në Kosovë. Megjithëse aktiviteti ekonomik në Kosovë u tkurr me diku rreth 6% sipas parashikimeve të marra nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), treguesit e performancës në sektorin financiar nuk u përkeqësuan gjatë kësaj periudhe. Sektori financiar në Kosovë edhe gjatë kësaj periudhe vazhdoi të mbetet likuid dhe i shëndoshë, gjë që u reflektua edhe në rezultatet e performancës së FKGK-së. Për sa i përket menaxhimit të riskut të shkaktuar nga pandemia e COVID-19, ndër hapat e parë që FKGK ndërmori ishte intensifikimi i komunikimit me IPF-të, që të kuptohet përmasa e krizës, të informohet lidhur me aktivitetet ose sektorët e prekur, masat që IPF-të kanë ndërmarrë si dhe pritjet që kanë lidhur me zhvillimet që mund të ndodhnin. Informacionet që u morën nga IPF-të kanë shërbyer për sajimin e stres-testeve me skenarë të ndryshëm që mund të ndodhnin, në mënyrë që të përgatiteshim për masat sipas skenarëve të ndryshëm.

Krahas kësaj, FKGK krijoi një mekanizëm për monitorimin e klientëve në sektorët e rrezikuar, si dhe monitorimin e huamarrësve të cilët janë vendosur nën moratorium ose ristrukturim të kredive. Krahas monitorimit të këtij grupi, FKGK krijoi rezerva shtesë të provizionimit me qëllim që të sigurojë mbulueshmëri të mjaftueshme në rast të përkeqësimit të kredive si rezultat i impaktit të pandemisë.

RISTRUKTURIMET E KREDIVE TË GARANTUARA GJATË COVID-19


Për të lehtësuar sfidat që u paraqitën gjatë COVID-19, FKGK u angazhua për lehtësimin e implementimit të rregulloreve të lëshuara nga BQK-ja që ndërlidheshin me shtyrjen e kësteve për huamarrësit e garantuar të prekur nga pandemia. Për implementimin e këtij procesi, FKGK ndryshoi proceset e brendshme në mënyrë që të lehtësoheshin proceset e ndërlidhura me shtyrjen e maturitetit të kredive. Faza e parë kishte të bënte me moratoriumin e kredive, proces që u zhvillua sipas udhëzimit nga BQK-ja në periudhën mars-qershor dhe përfshiu pothuajse 46% të portofolit të garantuar të FKGK. Faza e dytë kishte të bënte me ristrukturimin e kredive për huamarrësit e prekur nga COVID-19, proces po ashtu i zbatuar sipas udhëzimit nga BQK-ja, që përfshiu diku rreth 9% të portofolit të garantuar. Zgjatja e maturitetit të kredive gjatë kësaj periudhe mendohet që ka ndikuar mjaft në zbutjen e ndikimit të pandemisë në cilësinë e kredive të bankave si dhe në portofolin e garantuar nga FKGK.

KUALITETI I PORTOFOLIT

Përkundër gjendjes së përkeqësuar ekonomike, viti 2020 vijoi me rritje të portofolit të garantuar, ndërsa kualiteti i kredive të garantuara ishte në nivelin e parashikuar. Bilanci garantues sipas të dhënave më 31 dhjetor 2020 ishte në vlerë prej 55.93 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 27% nga viti paraprak. Megjithëse kualiteti i portofolit i matur kundrejt kredive delikuede dhe kredive jo-performuese (KJP) shënoi një rritje të vogël gjatë vitit 2020, ajo ngritje ishte në nivelin e parashikuar dhe ende është nën nivelin e sektorit në të cilin garantohet. Sipas të dhënave të fund-vitit, delikuenca e kredive të garantuara ishte 2.25%, përderisa norma e KJP-ve ishte 1.55%.

Viti 2020 shënon vitin e dytë të paraqitjes dhe pagesës së kërkesave. Gjithë kërkesat e paraqitura nga IPF-të për kreditë e kualifikuara janë vlerësuar në përputhje me marrëveshjen e garancisë dhe politikat e brendshme të FKGK-së.


PËRFORMANCA E KREDIVE TË GARANTUARA NË VITIN 2020



Gjatë vitit 2020, FKGK vazhdoi të qëndrojë prapa obligimeve të saj për të paguar kërkesat për kreditë e garantuara gjithsej në vlerë prej 228,900 euro, ndërsa vlera e përgjithshme e garantuar e kërkesave të paguara (duke përfshirë vitet paraprake) arriti vlerën prej 311,250 euro, që në raport me bilancin e garantuar është 0.56%. Shqyrtimi me kohë i kërkesave për pagesë dhe vlerësimi i tyre në përputhje me marrëveshjen garantuese dëshmon seriozitetin e FKGK-së dhe rritë besueshmërinë në raport me partnerët e saj.

FKGK vazhdoi ndërtimin e rezervave të provizionimit sipas modelit të humbjeve të pritshme. Për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia, FKGK shtoi rezervat e provizionimit, duke rritur nivelin e tyre për kreditë e garantuara në sektorët e vlerësuar si më të goditur nga kriza. Deri me 31 dhjetor 2020, gjithsej rezervat e provizionimit ishin 1,436.3 milionë euro që paraqet mbulueshmëri prej 2.6% në raport me bilancin e garantuar, përderisa mbulueshmëria e KJP-ve ishte 165.7%.

PROVIZIONI NË RAPORT ME BILANCIN E GARANTUAR



STRUKTURA E KAPITALIT DHE INVESTIMET

Kapitali i FKKG-së përbëhet nga fondet e dhuruara nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe nga donatorët ndërkombëtarë.

Në vitin 2016, kur është themeluar FKKG, shuma e kapitalit të dhuruar për FKKG-në ishte 7,345,141 euro, ndërsa gjatë vitit 2017 kjo vlerë u dyfishua, duke mbyllur vitin 2017 me kapital të dhuruar në shumën prej 15,790,921 euro. Dyfishimi i kapitalit ishte si rezultat i kontributit nga USAID-i, MTI-ja dhe KfW-ja, në fund të muajit dhjetor 2017. Gjatë viteve 2018 dhe 2019, FKKG nuk ka marrë kapital të ri. Viti 2020 ka rezultuar me një rritje të ndjeshme të kapitalit për FKKG-në. Qeveria e Republikës së Kosovës ka kontribuar në rritjen e kapitalit në shumë 21,410,000 euro dhe KfW-ja ka dhuruar shumë prej 11,500,000 euro.

Kapitalizimi i institucionit është i një rëndësie të veçantë për të mundësuar rritjen e potencialit garantues të FKKG-së dhe njëkohësisht për të transmetuar siguri në tregun financiar. FKKG përdor një politikë të levimit të kapitalit të saj që përcaktohet varësisht nga indikacionet e riskut në treg/sector, duke u siguruar që FKKG të ketë kapital të mjaftueshëm për ta kryer aktivitetin e saj dhe për t'i absorbuar humbjet e mundshme. Rritja e potencialit garantues ndikon në rritjen e kreditimit nga ana e institucioneve financiare, duke u ofruar


komoditet për të hulumtuar sektorë të rinj të tregut kreditor dhe në veçanti për të mbështetur sektorët më të pa favorizuar, e që janë me rëndësi të madhe për zhvillimin e sektorit privat dhe ekonomisë së Kosovës në tërësi.

Kapitali i FKKG-së investohet në institucionet partnere të FKKG-së, siç edhe specifikohet në ligj. FKKG e delegon besimin te institucionet partnere, duke lënë në menaxhim të tyre mjetet e investuara. Gjatë planifikimit për investime, FKKG kujdeset që të ofrojë likuiditet në tregun financiar dhe rrjedhimisht ndikon në rritjen e kreditimit nga ana e institucioneve financiare. FKKG gjithashtu optimizon normat e kthimit nga investimet, gjithmonë duke u kujdesur që të ruajë stabilitetin në treg, gjë që ka vazhduar edhe gjatë një situatë jo-stabile, siç ishte ajo e vitit 2020. Gjatë vitit 2020, FKKG ka investuar 23,778,921 euro në depozitat me afat me institucionet partnere financiare të FKKG-së, me maturitet njëvjeçar dhe dyvjeçar, duke vazhduar kështu bashkëpunimin shumëvjeçar në këtë drejtim.

Të ardhurat nga investimet konsolidohen në Pasqyrën e të Ardhurave, ndërsa fitimi vjetor ri-investohet ose mbahet në FKKG, duke e rritur kapitalin, dhe nuk shpërndahet jashtë FKKG-së në asnjë formë ose mënyrë, duke i përfshirë edhe dividendët.

	Qeveria e Republikës së Kosovës	USAID	KfW	Fitimi i akumuluar	Gjithsej
Kapitali 2016	2,000,000 €	5,345,141 €	-	(3,149.00)	7,341,992 €
Kapitali 2017	1,000,000 €	445,780 €	7,000,000 €	179,017.00 €	8,624,797 €
Kapitali 2018	-	-	-	320,012 €	320,012 €
Kapitali 2019	-	-	-	484,334 €	484,334 €
Kapitali 2020	21,410,000 €	-	11,500,000 €	66,312 €	32,976,312 €
Gjithsej	24,410,000 €	5,790,921 €	18,500,000 €	1,046,526 €	49,747,447 €
%	49%	12%	37%	2%	100%

DEPOZITAT ME AFAT SIPAS MATURITETIT



SISTEMI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

FKGK mban përgjegjësi të plotë për mjedisin dhe shoqërinë dhe së këndejmi kujdeset që të shmangë dhe zvogëlojë ndikimin negativ në mjedis nga investimet e mundësuar nga skema garantuese. Në mënyrë që të kontribuojë në zhvillimin ekonomik me përgjegjësi, FKGK ka filluar me implementimin e Sistemit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS).

Qëllimi i SMMS-së është të sigurojë që projektet e financuara (planet e investimeve të kredive të kualifikuara) të identifikojnë dhe adresojnë masat për të shmangur dhe minimizuar ndikimet mjedisore dhe sociale sipas legjislacionit përkatës të Kosovës, rregullave të Bankës Botërore dhe Standardit të Performancës IFC 1.

Në këtë drejtim, FKGK është e përkushtuar për identifikimin dhe adresimin e të gjitha risqeve mjedisore dhe sociale që lidhen me aktivitetet e veta garantuese. Në vitin 2020, FKGK vazhdoi me implementimin e Politikës së Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) sipas kërkesës së donatorëve duke u bazuar në standardet e IFC-së.

Objekti i PMMS-së është të përmbushë mandatin institucional me përgjegjësi të plotë ndaj mjedisit dhe shoqërisë dhe të sigurojë që IPF-të të kenë mbështetjen e duhur për të zvogëluar ndikimin negativ mjedisor të operacioneve të tyre.

Për të realizuar në mënyrë të plotë SMMS-në, FKGK në bashkëpunim me donatorët ka përditësuar PMMS-në, ka punësuar një ekspert mjedisor dhe social, si dhe ka ndërtuar një proces të monitorimit si dhe të raportimit.

Meqenëse jo të gjitha IPF-të kanë një sistem të tillë, FKGK me mbështetje nga Banka Botërore gjatë 2020 filloi përgatitjet për të mbështetur IPF-të në ndërtimin e SMMS-ve, si dhe në ndërtimin e kapaciteteve të tyre.

FKGK do të vazhdojë të mbështesë dhe të monitorojë IPF-të edhe në vitet në vijim, deri sa të vlerësojmë se IPF-të janë të gatshme të vazhdojnë në mënyrë të pavarur. E gjithë kjo vetëm e vetëm që të sigurohemi se investimet e bëra falë garancisë kreditore të FKGK-së të mos kenë impakt negativ në mjedisin dhe shoqërinë e vendit tonë.

VEÇORIA E VITIT 2020


PAKOJA E RIMËKËMBJES EKONOMIKE

Ndërkohë që pandemia e COVID-19 po bënte të vetën, NMVM-të filluan të ndienin efektet e saj në çdo aspekt. Që në fillim, FK GK mori përgjegjësinë për të ndihmuar sektorin e NMVM-ve me krijimin e produkteve garantuese të cilat do t'i përgjigjeshin vazhdimësisë së huadhënies për NMVM-të, në mënyrë që të përmbushej nevoja për likuiditet dhe financim të investimeve.

Duke marrë pjesë në mënyrë aktive në grupet punuese të inicuar nga Ministria e Financave për dizajnimin e pakos së rimëkëmbjes ekonomike, FK GK paraqiti vizionin se në ç'mënyrë do të mund të vihet në funksion më së miri instrumenti i skemës garantuese të FK GK-së me qëllim të adresimit të pasojave të krizës ekonomike të shkaktuar nga pandemia e COVID-19 dhe si kjo skemë do të duhej t'i përshtatet situatës së sapokrijuar. Kthimi i besimit në sektorin bankar me qëllim të evitimit të ngërçit kreditor, që më pastaj do të sillte mungesën e likuiditetit në treg, është identifikuar si një nga frontet në të cilat do të duhej të luftojë FK GK, gjatë dhe pas krizës së COVID-19. Për ta arritur këtë qëllim, në një situatë kur perceptimi i riskut kreditor në treg konsiderohet shumë më i lartë sesa në rrethana normale, është parë e nevojshme që skema garantuese e FK GK-së të ofrojë shkallë më të lartë të mbulueshmërisë me garanci. Prandaj, rritja e shkallës së garancisë kreditore, nga 50% sa ishte në 80%, u konsiderua si parakusht për të bërë ndryshim të ndjeshëm në treg. Në anën tjetër, në mënyrë që të adresoheshin nevojat specifike të segmenteve të caktuara të tregut, u dizajnuan dritare të veçanta garantuese me qëllim që t'i ndihmohej sektorëve që konsideroheshin strategjikë për ekonominë, si dhe segmenteve të marginalizuara në jetën afariste.

Në mënyrë që të realizohej kjo iniciativë e përbashkët në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe FK GK-së, kërkohesh ndryshimplotësimi i legjislacionin aktual që rregullon veprimtarinë e FK GK-së, si dhe dizajnimi i dritareve garantuese nga vetë strukturat e brendshme të FK GK-së.

Zbatimi i kësaj iniciative të përbashkët me QRK-në dhe donatorët ndërkombëtarë u bë i mundur pas miratimit të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike në Kuvendin e Kosovës dhe pas ratifikimit të Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike nga u.d. Presidentja e Republikës së Kosovës. Lidhur me këtë, FK GK lansoi dritaret në kuadër të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike, duke ofruar mbështetje për kreditimin në sektorët të caktuar, siç janë prodhimtaria, shërbimet, bujqësia, tregtia, me fokus të veçantë për gratë në biznes, bizneset start-up, si dhe investimet në efikasitet të energjisë.



PLATFORMA AGROSOFT

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) dhe Shoqatën e Bankave të Kosovës (SHBK), lansuan platformën AgroSoft, projekt ky i mbështetur nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW). Platforma virtuale AgroSoft do t'i ndihmojë institucionet financiare për analizë sa më të saktë gjatë financimit

bujqësor. Kjo platformë që është e lehtë për t'u përdorur, dinamike dhe e qasshme nga pajisje të ndryshme elektronike (desktop, laptop, tablet apo smartfon), si dhe e përditësuar nga MBPZHR-ja me të dhënat më të reja, do t'u mundësojë institucioneve financiare dhe palëve tjera relevante që të ngushtojnë hendekun e asimetrisë së informacionit ndërmjet fermerit, institucionit financiar dhe tregut.





PJESAV

AKTIVITETET GJATË VITIT 2020

LIDHJA E MARRËVESHJEVE TË REJA



PRILL 2020

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA FINANCIARE PËR RITJE TË KAPITALIT GARANTUES TË FKGK-SË

Ministri në detyrë i Financave dhe Transfereve, Besnik Bislimi dhe drejtori i Zyrës së KfW-së për Kosovë, Rene Eschemann, nënshkruan marrëveshjen financiare për rritje të kapitalit garantues të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore në vlerë prej 6.5 milionë euro, me fokus në mbështetjen e kreditimit për sektorin e agrobiznesit.



SHTATOR 2020

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR NDIHMË NDËRMJET MF-SË DHE FKGK-SË

Zëvendësministri i Financave, Agim Krasniqi, dhe Drejtori Menaxhues i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, Besnik Berisha, nënshkruan marrëveshjen për ndihmë në vlerë prej rreth 22.3 milionë euro. Kjo marrëveshje vjen si rezultat i marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore për Projektin e Fuqizimit të Sektorit Financiar.



SHTATOR 2020

MFK, FKGK DHE MF NËNSHKRUAJNË LETRËN E QËLLIMIT

Fondacioni i Mijëvjeçarit të Kosovës (MFK), Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) dhe Ministria e Financave (MF) nënshkruan letrën e qëllimit për fillimin e financimit tregtar me vlerë deri në 25 milionë euro për projekte të energjisë së ripërtëritshme dhe eficientë të energjisë. Palët nënshkruan letrën e qëllimit në praninë e Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC) dhe delegacionit të Korporatës Amerikane Financiare për Zhvillim Ndërkombëtar (DFC), të cilët ishin për vizitë në Kosovë për avancimin e bashkëpunimit dhe zhvillimit ekonomik.



NËNTOR 2020

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA FINANCIARE PËR RITJE TË KAPITALIT GARANTUES TË FKKG-SË

Drejtori i Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) për Evropën Juglindore dhe Turqinë, Dr. Klaus Müller, dhe Drejtori Menaxhues i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, Besnik Berisha, nënshkruan marrëveshjen financiare për rritje të kapitalit garantues të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore në vlerë prej 6.5 milionë euro. Kjo mbështetje ofrohet nga qeveria gjermane për fuqizimin e huadhënies për sektorin e biznesit në përgjithësi, për të evituar pasojat e krizës si rrjedhojë e pandemisë së COVID-19. Linjat garantuese të cilat janë financuar në tërësi nga qeveria gjermane, me ndërmjetësim nga KfW-ja, tashmë mbështeten me kapital prej 18.5 milionë euro.



DHJETOR 2020

IMPLEMENTIMI I PROJEKTIT TË BANKËS BOTËRORE PËR FUQIZIMIN E SEKTORIT FINANCIAR NË KOSOVË

Si rezultat i marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore për Projektin e Fuqizimit të Sektorit Financiar, kapitali i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore u rrit në vlerë prej 21.4 milionë euro. Përmes Projektit për Fuqizimin e Sektorit Financiar, Banka Botërore synon të mbështetë rimëkëmbjen e ekonomisë së Kosovës, përmes mbështetjes së qasjes në financa duke krijuar dritare garantuese për segmente të caktuara të tregut, siç janë gratë në biznes, ndërmarrësit e rinj dhe sektori i prodhimit, si dhe synon të avancojë kapacitetet financiare dhe teknike të FKKG-së përmes ofrimit të asistencës teknike. Vlera totale e marrëveshjes për ndihmë, duke përfshirë edhe asistencën teknike, është rreth 22.3 milionë euro. Përmes këtij kapitali, FKKG do të fuqizojë rolin e vet në përpjekjet për luftimin e efekteve negative të shkaktuara nga pandemia e COVID-19 në kuadër të Pakos për Rimëkëmbje Ekonomike.

PUNËTORITË/SEMINARET



JANAR 2020

FKGK DHE MFK SË BASHKU NË MBËSHTETJE TË INVESTIMEVE NË ENERGJINË E RIPËRTËRITSHME SOLARE

Fondacioni i Mijëvjeçarit të Kosovës i (MFK) së bashku me Korporatën e Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC) dhe Fondin Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) organizuan një sesion informues ekzekutiv për komunitetin e donatorëve, organizatat ndërkombëtare zhvillimore dhe financiare, në mënyrë që të ofrojnë më shumë informacione mbi projektin në vlerë prej 5 milionë dollarë të MFK-së për mbështetjen e prodhuesve të pavarur të energjisë së ripërtëritshme (IPP).



SHKURT 2020

FKGK PREZANTON ROLIN E VET INSTITUCIONAL NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË VENDIT

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore prezanton rolin e tij institucional në zhvillimin ekonomik të vendit, me theks të veçantë të përkrahja e agrobizneseve vendore. Gjatë prezantimit para anëtarëve të Shoqatës së Përpunuesve të Pemëve dhe Perimeve të Kosovës (PePeKo) dhe të Shoqatës Nationale të Mjedarave u diskutua rreth qasjes sa më të lehtë në financa që duhet të jetë në dispozicion për agrobizneset vendore të këtij nën-sektori.



PRILL 2020

FKGK MERR PJESË NË FORUMIN VIRTUAL TË ORGANIZUAR NGA AMCHAM

Drejtori Menaxhues i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, z. Besnik Berisha mori pjesë në forumin virtual të organizuar nga AmCham me temën "Roli i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore në trajtimin e ndikimit të COVID-19". Në këtë panel, z. Berisha njoftoi pjesëmarrësit për veprimtarinë aktuale të FKGK-së, si dhe për masat që po ndërmerren nga FKGK, në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës dhe donatorët ndërkombëtarë, për të mbështetur NMVM-të dhe institucionet partnere financiare gjatë pandemisë së COVID-19.



MAJ 2020

FKGK ORGANIZON TAKIMIN KOORDINUES ME DONATORËT DHE PARTNERËT E VET

Informimi rreth iniciativave dhe zhvillimeve, koordinimi ndërmjet tyre për krijimin e mundësive të reja për të ndihmuar NMVM-të për të tejkaluar situatën e shkaktuar nga pandemia përmes Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, ishin disa nga diskutimet e zhvilluara në këtë takim. Në takim

morën pjesë përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Transfereve si dhe përfaqësues të donatorëve ndërkombëtarë, siç janë: KfW, Zyra e USAID-it në Kosovë, Sida, Banka Botërore, Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim (EBRD), Banka Evropiane për Investime (EIB), Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC) dhe Ambasada e Japonisë në Kosovë.



TETOR 2020

FKGK PJESË E EDICIONIT TË TRETË TË JAVËS SË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TË KOSOVËS

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, mori pjesë në panelin virtual me temën "Rimëkëmbja ekonomike nga COVID-19 përmes energjisë së pastër". Gjatë diskutimit në panel, z. Berisha theksoi se Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), në kuadër të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike planifikon mbështetjen e financimit të projekteve me fokus të veçantë në sektorin e energjisë së ripërtëritshme-solare dhe të efijencës së energjisë.




TETOR 2020

TRAJNIMI PËR NGRITJE TË NJOHURIVE INSTITUCIONALE PËR ENERGJI TË RIPËRTËRITSHME DHE EFIJENCË TË ENERGJISË

Punonjësit e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore morën pjesë në trajnimin dyditor për energji të ripërtëritshme dhe efijencë të energjisë, që u mbajt nga ekspertët e Financial Markets International Inc. Ky trajnim, i cili është pjesë e një prej tri ndërhyrjeve

kyçe të marrëveshjes së lidhur ndërmjet MFK-së dhe FKGK-së që ka për qëllim të krijojë një mjedis më të favorshëm për financimin e energjisë së ripërtëritshme në Kosovë, u fokusua te mbështetja e FKGK-së për zhvillimin e kapaciteteve institucionale lidhur me ngritjen e njohurive financiare për tregun e energjisë solare, si dhe për krijimin e një dritareje garantuese për financimin e projekteve të energjisë së ripërtëritshme solare dhe investimeve që rritin efijencën e energjisë.



TETOR 2020

TRAJNIMI PËR PËRDORIMIN E PLATFORMËS AgroSoft

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore mbajti trajnimet e para virtuale rreth përdorimit të platformës AgroSoft me stafin e përzgjedhur të bankave partnere. Përpos garancive kreditore, përmes platformës AgroSoft, FKKG ndihmon qasjen më të lehtë në financa për fermerët dhe agrobizneset vendore, duke përkrahur një vendimmarrje sa më të lehtë dhe sa më të besueshme për kreditim.

DHJETOR 2020

FKKG PJESË E KONVENTËS VJETORE TË SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS PËR 2020, "BANKIMI NË KOHËN E COVID-19"

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore mori pjesë në panelin virtual me temën "Sfidat dhe qëndrueshmëria e Bankave në Kosovë gjatë pandemisë COVID-19: Rimëkëmbja dhe ndryshimet e pritshme në sektorin bankar". Në këtë panel, z. Berisha njoftoi pjesëmarrësit për veprimtarinë aktuale të FKKG-së, si dhe për masat që është duke i ndërmarrë FKKG, në bashkëpunim me qeverinë e Kosovës dhe donatorët ndërkombëtarë, për të mbështetur NMVM-të dhe institucionet partnere financiare gjatë pandemisë së COVID-19. Gjatë diskutimit në panel, z. Berisha po ashtu njoftoi pjesëmarrësit lidhur me dritaret e reja, si dhe për lehtësitë e ofruara për sektorët dhe segmentet më pak të shërbyera, siç janë: bujqësia, gratë në biznes dhe bizneset start-up, duke inkurajuar institucionet partnere financiare që këtyre sektorëve dhe segmenteve t'u mundësohet qasja në financa, gjithnjë duke u siguruar që të mos ketë rritje të detyrimeve në nivelin që do të ishte mbingarkesë për përfuturit e fundit.



TRAJNIMET ORIENTUESE DHE RIFRESKUESE ME INSTITUCIONET PARTNERE FINANCIARE

Trajnimet orientuese dhe rifreskuese me IPF-të synojnë ngritjen e nivelit të informimit të personelit të IPF-ve lidhur me shërbimet e FKKG-së, karakteristikat e garancive kreditore, sesi shërbimet e tilla bëjnë ndryshimin dhe sjellin përfitime për të gjitha palët e lidhura, pra për vetë IPF-të, për NMVM-të, si dhe për ekonominë në përgjithësi. Gjatë vitit 2020, personeli i FKKG-së ka zhvilluar një sërë trajnimesh orientuese për zyrtarët kreditore, të cilët janë përgjegjës për analizën e kredive dhe analizën e riskut dhe të cilët bashkëveprojnë drejtpërdrejt me FKKG-në (personelin dhe sistemin), si dhe me klientët (NMVM-të). Këto trajnime ishin specifike për implementimin e platformës AgroSoft dhe rifreskim i njohurive për produktet standarde.

STORIE SUKSESI



HIT-FLORES - QENDËR GRUMBULLUESE NË MALET E SHARRIT


Hit-Flores është një kompani e cila merret me grumbullimin dhe përpunimin e bimëve mjekësore, kërpudhave dhe frutave të malit. Kompania gjithashtu merret me përpunimin dhe paketimin e çajit që mbledhet drejtpërdrejt nga Malet e Sharrit.

"Ne filluam biznesin tonë në vitin 2005, fillimisht me grumbullimin e frutave të malit dhe gradualisht duke u zgjeruar edhe në grumbullimin e bimëve mjekësore dhe kërpudhave. Qëllimi ynë kryesor

është që përmes grumbullimit të frutave dhe bimëve mjekësore me cilësi të lartë nga malet e bukura të Sharrit, si dhe përmes klasifikimit dhe paketimit të duhur, të jemi të pranishëm në tregjet ndërkombëtare", thekson z. Arafat Bajrami, pronar i biznesit Hit Flores.

Aktualisht kompania është duke bashkëpunuar me më shumë se 4,000 fermerë dhe me kompani të ndryshme ndërkombëtare nga dhjetë shtete të Evropës. Kompania bashkëpunon me fermerët vendas nga rajoni i Dragashit, Shtërpçës, Brezovicës, Mitrovicës, Vushtrrisë, si dhe me fermerë nga veriu i Shqipërisë. Kompania punëson 28 punëtorë të përhershëm dhe 70-120 punëtorë stinorë sipas nevojës.

"Me zgjerimin e vazhdueshëm të aktiviteteve të kompanisë, kuptuam që kishim nevojë për investime në zgjerim të objektit në mënyrë që aktiviteti ynë të mbështetet sa më mirë. Këtë investim e arritëm me kredinë që u garantua nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë", thekson z. Bajrami. Përmes investimit të bërë, kompania arriti të krijojë hapësirë më të mirë për deponimin dhe konservimin e produkteve, duke i bërë ato të gatshme për plasim në tregjet vendore dhe ndërkombëtare.



ARBËRIA GROUP - PRODHUESE E UJIT NATYRAL MINERAL "UJË I ALPEVE"

Arbëria Group është kompani e cila merret me prodhimin e ujit natyral mineral "Ujë i Alpeve" dhe me prodhimin e lëngjeve të gazuara.

"Ishte viti 2010 kur themeluam fabrikën e Ujit të Alpeve me qëllim që të prodhojmë dhe sjellim ujë cilësor natyror nga burimi deri te sofa e konsumatorëve. Uji natyral i Alpeve buron nga thellësia e maleve të Gollakut

në fshatin Koliq, në një lartësi mbidetare mbi 1,200 metra, nga një burim i lashtë uji natyral mineral, i njohur si ujë me cilësi të lartë", thekson z. Afrim Osmani, pronar i biznesit.

Aktualisht, kompania është duke bashkëpunuar me më shumë se 1,500 kompani vendore, hipermarkete dhe supermarketet vendore, si dhe shitës me pakicë.

"Që nga 2010-ta, kompania jonë ka arritur që të zgjerohet, duke shtuar linjat prodhuese dhe numrin e të punësuarve, dhe të njihet si emër në mesin e konsumatorëve. Për të ofruar një cilësi të lartë, ne e ambalazhojmë ujin me teknologji moderne evropiane të certifikuar sipas standardeve evropiane, teknologji e cila mundëson që Uji i Alpeve t'i ruajë të gjitha vetitë natyrale nga burimi. Por, përpos teknologjisë së avancuar që kemi, për të realizuar planifikimet dhe për të qenë konkurrues në treg, ne kishim nevojë të investojmë edhe për kapitalin punues. Këtë investim e arritëm me kredinë që u garantua nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë", thekson z. Osmani.

Përmes investimit të bërë, kompania arriti të realizojë prodhimin si dhe shitjet e planifikuara, gjë që njëkohësisht rezultoi me zhvillim të biznesit.

TAKIMET E BORDIT TË DREJTORËVE DHE TË KOMITETEVE PËRKATËSE

MBLEDHJET E BORDIT TË DREJTORËVE TË FK GK-SË

Gjatë vitit 2020, Bordi i Drejtorëve i FK GK-së mbajti gjithsej gjashtë (6) mbledhje, nga të cilat pesë ishin mbledhje të rregullta dhe një mbledhje ishte e jashtëzakonshme. Në mbledhjet e Bordit janë marrë disa vendime të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të FK GK-së, si dhe për marrëdhëniet e FK GK-së me palët e treta.

MBLEDHJET E KOMITETIT TË MENAXHIMIT TË RISKUT DHE KOMITETIT TË AUDITIMIT

Gjatë vitit 2020, Komiteti i Menaxhimit të Riskut (KMR) mbajti katër (4) mbledhje të rregullta dhe Komiteti i Auditimit (KA) mbajti katër (4) mbledhje të rregullta. Në këto takime, komitetet përkatëse nxorën vendime dhe rekomandime për shqyrtim nga menaxhmenti i FK GK-së dhe për miratim përfundimtar nga Bordi i Drejtorëve i FK GK-së.

Tabela në vijim paraqet një pasqyrë të mbledhjeve të Bordit dhe të komiteteve ndihmëse të Bordit të Drejtorëve të FK GK-së:

Orari i mbledhjeve të Bordit	Pjesëmarrja e anëtarëve të Bordit	Numri i temave të diskutuara	Numri i vendimeve të nxjerra
21 shkurt 2020	7/7	8	3
07 maj 2020	7/7	1	0
29 maj 2020	7/7	4	3
21 gusht 2020	7/7	9	6
21 tetor 2020	7/7	7	4
18 dhjetor 2020	6/7	3	3
Gjithsej:		32	19

Orari i mbledhjeve të KMR-së	Pjesëmarrja e anëtarëve të KMR-së	Numri i temave të diskutuara	Numri i vendimeve/rekomandimeve të nxjerra
11 shkurt 2020	4/4	1	0
12 maj 2020	4/4	4	1
10 gusht 2020	4/4	4	3
04 nëntor 2020	4/4	5	4
Gjithsej:		14	8

Orari i mbledhjeve të KA-së	Pjesëmarrja e anëtarëve të KA-së	Numri i temave të diskutuara	Numri i vendimeve/rekomandimeve të nxjerra
19 shkurt 2020	4/4	4	0
07 maj 2020	4/4	4	0
07 gusht 2020	4/4	4	0
05 nëntor 2020	4/4	1	1
Gjithsej:		13	1



대한민국 보건복지부
대한민국 보건복지부
대한민국 보건복지부

Document No. KCGF-06-16





PJESA VI

PASQYRAT FINANCIARE TË AUDITUARA

**FONDI KOSOVAR PËR GARANCI
KREDITORE**

**Raporti i Auditorit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare për vitin që ka
përfunduar më 31 dhjetor 2020**

PËRMBAJTJA

	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	1
Pasqyra e Pozicionit Financiar	3
Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	4
Pasqyra e Ndryshimeve në Bilancin e Fondit	5
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë	6
Shënimet e Pasqyrave Financiare	7 - 30

Raporti i Auditorit të Pavarur

Për Bordin e Drejtorëve të
Fondit Kosovar Për Garanci Kreditore

Grant Thornton LLC
Rexhep Mala 18
10000 Pristina
Kosovo
T +383 (0)38 247 801
F +383 (0)38 247 802
E Contact@ks.gt.com
VAT No. 330086000

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Fondit Kosovar Për Garanci Kreditore ("Fondi"), të cilat përfshijnë pasqyrën e të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020, pasqyrën të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parash për vitin e përfunduar, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit më 31 dhjetor 2020, si dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parash për vitin e përfunduar, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë të përshkruara në mënyrë më të detajuar në paragrafin e raportit tonë Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Fondi në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK), së bashku me kërkesat etike që janë të rëndësishme për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne poashtu kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që konsiderohen të nevojshme nga menaxhmenti për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Fondit për të vazhduar se përmbushuri parimin e vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë e biznesit dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë, përveç kur menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë Fondin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nuk ka ndonjë mundësi tjetër përveç se të veprojë në këtë mënyrë.

Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.

Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Qëllimet tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin që pasqyrat financiare në terësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë si pasojë e mashtrimeve ashtu edhe e gabimeve, dhe lëshimin e një raporti auditimi i cili përmban opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion i asaj që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të, do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të lindin si rezultat i mashtrimeve ose gabimeve dhe konsiderohen materiale nëse individualisht, ose të bashkuara, mund të pritët në mënyrë të arsyeshme që të ndikojnë në vendimet ekonomike të shfrytëzuesve të pasqyrave financiare, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.


Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, si pasojë nga mashtrimet apo edhe si pasojë e gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedura të auditimit të cilat i përgjigjen këtyre risqeve dhe marrim evidencat të auditimit të cilat janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Risku i mos-zbulimit të një anomalie materiale e cila rrjedhë nga mashtrimi është më i madh sesa i atij që rrjedhë nga gabimi, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që është relevante me auditimin në mënyrë që të dizajnojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme me rrethanat, mirëpo jo me qëllim për dhënien e një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Fondit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël si dhe shpalosjet e bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim përfundime në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së hipotezës së vijimësisë së kontabilitetit, duke u bazuar në evidencat e auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të shkaktojnë dyshim të lartë që Fondi mund të vazhdojë operimin. Nëse ne vijmë në përfundim se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit në shpalosjet e pasqyrave financiare ose nëse shpalosjet e tilla janë jo të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat tona të auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë. Sidoqoftë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që Fondi -ja të ndërpresë së pëmbushuri parimin e vijimësisë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare të prezentojnë transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen e Fondit Kosovar Për Garanci Kreditore, përpos të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Grant Thornton LLC
Prishtinë,

1 qershor 2021


Suzana Stavrikj
Auditor ligjor



	Shënimet	Më 31 dhjetor 2020 (euro)	Më 31 dhjetor 2019 (euro)
ASETET			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	4	28,089,205	735,567
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	5	231,824	381,374
Depozitat	6	24,050,187	16,891,934
Asetet me të drejtë përdorimi	7	79,324	26,927
Prona, impiantet dhe pajisjet	8	24,605	2,032
Asetet e paprekshme	9	25,119	40,203
GJITHSEJ ASETET		52,500,263	18,078,037
DETYRIMET DHE EKUITETI			
Shpenzimet akruale		29,275	9,206
Detyrimet e qirasë	7	81,302	27,468
Rezervat e humbjeve nga garancionet e kredive	16	1,445,576	688,299
Të hyrat e shtyra	10	612,850	32,110
Tarifat akruale te garancisë		583,813	549,819
Gjithsej detyrimet		2,752,816	1,306,902
Ekuiteti			
Kapitali	11	48,700,921	15,790,921
Fitimi i akumuluar		1,046,526	980,214
Gjithsej ekuiteti		49,747,447	16,771,135
GJITHSEJ EKUITETI DHE DETYRIMET		52,500,263	18,078,037

Autorizohet për lëshim nga menaxhmenti dhe nënshkruar në emër të tij më 31 maj 2021.

Besnik Berisha
Drejtor Menaxhues



Vjosa Balaj
Menaxhere e Lartë e Financave

Shënimet shoqëruese në faqet 7 deri 30 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare.

	Shënimet	Për vitin 31 dhjetor 2020 (euro)	Për vitin 31 dhjetor 2019 (euro)
Tarifat e garancisë	12	1,061,886	814,289
Të ardhurat tjera	13	349,561	461,242
Gjithsej të ardhurat		1,411,447	1,275,531
Shpenzimet e personelit	14	(205,779)	(176,188)
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	7,8,9	(46,748)	(43,647)
Shpenzimet operative	15	(106,436)	(100,395)
Provizioni neto për humbje nga garancionet	16	(986,172)	(470,967)
Fitimi i vitit		66,312	484,334
Të Ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		66,312	484,334

Shënimet shoqëruese në faqet 7 deri 30 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
Pasqyra e Ndryshimeve në Bilancin e Fondit
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2020

	Kapitali (euro)	Fitimi i Akumuluar (euro)	Gjithsej (euro)
Më 1 janar 2019	15,790,921	495,880	16,286,801
Fitimi e vitit	-	484,334	484,334
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Më 31 dhjetor 2019	15,790,921	980,214	16,771,135
Më 1 janar 2020	15,790,921	980,214	16,771,135
Kapital shtesë	32,910,000	-	32,910,000
Fitimi i vitit	-	66,312	66,312
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Më 31 dhjetor 2020	48,700,921	1,046,526	49,747,447

Shënimet shoqëruese në faqet 7 deri 30 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare.

Shënimet	Për vitin 31 dhjetor 2020 (euro)	Për vitin 31 dhjetor 2019 (euro)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operuese:		
Fitimi i vitit	66,312	484,334
Korrigjimet për:		
Zhvlerësimin	7,8,9	25,696
Interesit në depozita	(282,648)	(245,050)
Shpenzimet e interesit për detyrimet e qirasë	(4,974)	(1,430)
	(174,562)	263,550
Lëvizjet në kapitalin qarkullues:		
Rritja në të arkëtueshmet tjera	149,550	(91,756)
Rritja në akrualet e tarifave të garancive	33,994	147,135
Rritja në rezervat e humbjeve nga garancionet	757,277	388,616
(Zvogëlimi)/Rritja në të hyrat e shtyra nga asetet e dhuruara	580,740	(8,737)
Rritja në akruale	20,070	(4,406)
Rritja në detyrime të qirasë	4,441	19,381
Interesi i paguar për detyrimet e qirasë	4,974	1,430
Neto para e (perdorur)/gjeneruar në aktivitetet operuese	1,376,484	715,213
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese:		
Blerja e aseteve afatgjata	8,9	(16,467)
Rritja në depozitat me afat	(7,158,876)	(1,058,045)
Interesi i arkëtuar nga depozitat	283,271	152,667
Neto para e përdorur nga aktivitetet investuese	(6,906,496)	(921,845)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Shlyerja e detyrimit të qirasë	(26,350)	(18,840)
Kapitali i paguar	32,910,000	-
Neto para e gjeneruar nga aktivitetet financuese	32,883,650	(18,840)
Neto (zvogëlimi)/rritja e parasë dhe ekuivalentëve të saj gjatë vitit	27,353,638	(225,472)
Para dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	735,567	961,039
Para dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	4	735,567

Shënimet shoqëruese në faqet 7 deri 30 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare.

1. TË PËRGJITHSHME

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ("FKGK" ose "Fondi") është institucion i pavarur dhe i qëndrueshëm që lëshon garanci për institucionet financiare për të mbuluar rrezikun për kreditë e NMVM-ve (Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme).

FKGK u krijua, për shkak të një iniciative të përbashkët midis Donatorëve Ndërkombëtarë në Kosovë (kryesisht USAID dhe KFW) dhe Qeverisë së Kosovës, në janar 2016, bazuar në Ligjin për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore.

Përmes "Ligjit për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore " Ligji Nr. 05 / L-057 themeloi FKGK-në si një institucion të pavarur, jo-fitimprurës, publik, entitet autonom, juridik dhe përcaktoi autoritetin, strukturën, qeverisjen, operacionet e tij, fushëveprimin, politikat dhe procedurat për lëshimin e garancioneve të kredisë.

Ligji themelues për FKGK-në u inicua nga MTI (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë), ndërsa USAID në Kosovë, përmes Programit EMPOWER Mbështetja e Kredisë (ECS) mbështeti institucionin për t'u bërë funksional. Ligji hyri në fuqi më 23 janar 2016. Kapitali i FKGK-së përbëhet nga fonde të dhuruara nga USAID, KfW dhe Qeveria e Kosovës.

FKGK është krijuar për të ndihmuar në plotësimin e nevojës për qasje të shtuar në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në Kosovë, me qëllim të krijimit të vendeve të punës, rritjen e prodhimit vendor dhe shërbimeve të shtuara me vlerë, dhe përmirësimin e bilancit tregtar dhe rritjen e mundësive të financimit për NMVM-të.

FKGK është institucion i pavarur, autonom, juridik, i themeluar me Ligj, me personalitet të plotë juridik, dhe një identitet juridik që është i veçantë nga Bordi Menaxhues i FKGK-së dhe Ekzekutivët.

FKGK drejtohet nga Bordi i Drejtorëve i përbërë nga shtatë anëtarë të cilët bashkërisht kanë shumë vite përvojë në menaxhimin financiar, menaxhimin e rrezikut, të drejtën tregtare e financiare, si dhe auditimin. Bordi siguron udhëheqje dhe mbikëqyrje për të gjitha aktivitetet e FKGK-së.

FKGK-ja është themeluar me qëllim të sigurimit të pjesshëm të garancive të kredive për institucionet financiare, për kreditë që i jepen NMVM-ve, deri në shumën e mbulimit të përcaktuar me LFKGK dhe Marrëveshjes së Garancisë ndërmjet FKGK-së dhe institucionit financiar.

Për qëllimet e veprimtarisë kryesore, FKGK-ja është përgjegjëse për:

- a. Lëshimin e Garancive Kreditore në përputhje me LFKGK-në dhe politikat e brendshme të miratuara nga Bordi i Drejtorëve.
- b. Vendosjen e kushteve për regjistrimin e institucioneve të kualifikuara financiare të Kosovës në FKGK, sipas Politikës për Regjistrimin e Institucioneve Financiare.
- c. Caktimin e kushteve për lëshimin e Garancive Kreditore nga FKGK-ja.
- d. Caktimin e Tarifave të Garancive të FKGK-së.
- e. Depozitimin apo investimin e drejtpërdrejtë, apo përmes delegimit të autorizimeve, të aseteve të FKGK-së brenda kufizimeve të LFKGK-së.
- f. Pagesën e Shumave të pagueshme për Garancitë Kreditore për institucionet financiare të regjistruara në pajtim me dispozitat e LFKGK-së dhe Marrëveshjes së Garancisë, në përputhje me dispozitat e LFKGK-së dhe Politikave për Trajtimin e Kërkesave.

1. TË PËRGJITHSHME (VAZHDIM)

Kapitali minimal i FKKG-së është 300,000.00 Euro, sipas nenit të 10 të LFKKG-së (Ligji për Fondin Kosovar për Garanci Kreditore). Organet qeverisëse të FKKG-së janë Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori Menaxhues. Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë drejtues i FKKG-së. Numri fiskal i FKKG-së është 601642061.

Operacionet e FKKG-së dhe të gjitha aktivitetet administrative janë të pavarura që nga data 10 qershor 2017 dhe janë nën menaxhimin e Fondit.

Më 6 dhjetor 2017 Fondi për Garantimin e Kredive të Kosovës (FKKG) nënshkroi Marrëveshjen e Garancisë me Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida), përfaqësuar nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë.

Më 14 maj 2019 Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKKG) nënshkroi Marrëveshjen e Garancisë me Fondin European Investues nën programin COSME LGF (loan guarantee facility).

Mbështetja e portofolit të garantuar të FKKG-së nga Sida dhe COSME, do të rrisë më tej aftësinë e Fondit për të siguruar një nivel më të lartë të garancive të kredisë, duke rritur në të njëjtën kohë qëndrueshmërinë financiare të sektorit. Qëndrueshmëri do të reflektojë në lehtësimin e ndërmjetësimit financiar, duke rritur kështu qasjen në financimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, me qëllim të promovimit të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të punës për gra, burra dhe të rinjtë e të gjitha etnive në Kosovë.

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL KONTABILITETIT

2.1 Baza e përgatitjes dhe deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), siç janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Pasqyrat financiare janë përgatitur me anë të bazave të vlerësimit të specifikuar nga SNRF-ja për çdo lloj aset, detyrimi, të ardhurash apo shpenzimesh. Bazat e vlerësimit janë të përshkruara në hollësi në Shënimin si me poshtë.

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me IFRS-në kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kritike të kontabilitetit. Gjithashtu kërkon nga menaxhmenti të shfrytëzojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Fondit. Fushat ku janë bërë gjykime dhe vlerësime të rëndësishme gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare dhe efektet e tyre shpalosen në shënimin 3.8.

Ndikimi nga pandemia e Covid-19

Zhvillimi i shpejtë i virusit COVID-19 dhe ndikimi i tij social dhe ekonomik në Kosovë dhe globalisht ka ndikuar në ekonominë e Kosovës. Si rezultat i pandemisë, ekonomia është ndikuar negativisht duke krijuar një rënie të kërkesës agregate dhe duke prekur kështu sektorin financiar. Një nga masat e marra gjatë kësaj kohe, ishte moratoriumi për ripagimin e huasë i cili gjithashtu reflektohet në KCGF. Kjo masë konsiderohet efektive për të ndikuar në likuiditetin e bizneseve gjatë një kohe të vështirë. Gjithashtu, ndikimi pasues është në ruajtjen e cilësisë së portofolit deri në një moment të rimëkëmbjes së bizneseve nga kufizimet e pandemisë.

Përkundër Pandemisë, KCGF ka një pozicion shumë të qëndrueshëm të likuiditetit, si rezultat ai vazhdoi të përmbushë detyrimet e tij gjatë kësaj kohe. Zhvillimet e portofolit dhe rreziku i garancisë janë monitoruar dhe hapat e nevojshëm janë ndërmarrë duke alokuar provizione shtesë që konsiderohen të nevojshme.

Këto rrethana nuk ndikuan në përshtatshmërinë e supozimit të shqetësimit të vazhdueshëm të Fondit.

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

2.1 Baza e përgatitjes dhe deklarata e pajtueshmërisë (vazhdim)

2.1.1 *Standartet dhe Interpretimet efektive në periudhën aktuale*

Ndryshimet e reja në vijim të standardeve ekzistuese të lëshuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (BNSK) janë efektive për periudhën aktuale të raportimit:

- **Ndryshimet në SNRF 3 “Kombinimet e Biznesit”** - Përkufizimi i një biznesi (efektive për periudhën vjetore që fillon në ose pas 1 janarit 2020).
- **Ndryshimet në SNRF 9 “Instrumentet Financiare”, SNK 39 “Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja” dhe SNRF 7 “Instrumentet Financiare: Shpalosje”** - Reforma në normën referente të interesit (efektive për periudhën vjetore që fillon në ose pas 1 janarit 2020).
- **Ndryshimet në SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare” dhe SNK 8 “Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet e Kontabilitetit dhe Gabimet”** - Përkufizimet e materialitetit (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).
- **Ndryshimet në Referencat e kornizës Konceptuale në Standardet e SNRF-ve** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).
- **Ndryshimet në SNRF 16 “Qiratë” - Koncesionet e qirave që lidhen me COVID-19** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 qershor 2020).

2.1.2 *Standardet dhe interpretimet e lëshuara nga BSNK por ende jo efektive dhe jo të aplikuara më herët nga FKGK*

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare në vijim janë standardet, rishikimet dhe interpretimet e mëposhtme por që nuk janë ende efektive:

- **SNRF 17 “Kontratat e sigurimit”** duke përfshirë ndryshimet në SNRF 17 (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023).
- **Ndryshimet në SNRF 3 “Kombinimet e Biznesit”** - Referencë e Korinizës Konceptuale me ndryshimet në SNRF 3 (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022).
- **Ndryshimet në SNRF 4 “Kontratat e Sigurimit”** - Zgjatja e përjashtimit të përkohshëm nga zbatimi i SNRF 9 (data e skadimit të përjashtimit të përkohshëm nga SNRF9 është shtyrë për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023).
- **Ndryshimet në SNRF 9 “Instrumentet Financiare”, SNK 39 “Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja” dhe SNRF 7 “Instrumentet Financiare: Shpalosjet”, SNRF 4 “Kontratat e Sigurimit” dhe SNRF 16 “Qiratë”** - Reforma e Standardit të Normës së Interesit - Faza 2 (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2021).
- **Ndryshimet në SNRF 10 “Pasqyrat Financiare të Konsoliduara” dhe SNK 28 “Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta”** - Shitja ose Kontributi i Pasurive midis një Investitori dhe një Ndërmarrje të Bashkuar me të ose Ndërmarrje të Përbashkët dhe ndryshimet e tjera (data e hyrjes në fuqi shtyhet pafundësisht derisa të përfundohet projekti kërkimor mbi metodën e kapitalit neto).
- **Ndryshimet në SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”** - Klasifikimi i detyrimeve afatshkurtëra dhe afatgjata (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023).
- **Ndryshimet në SNK 16 “Prona, impiantet dhe paisjet”** - Të ardhurat para përdorimit të synuar (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022).

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

2.1 Baza e përgatitjes dhe deklarata e pajtueshmërisë (vazhdim)

2.1.1 *Standardet dhe interpretimet e lëshuara nga BSNK por ende jo efektive dhe jo të aplikuara më herët nga FKGK (vazhdim)*

• **Ndryshimet në SNK 37 “Provizionet, Detyrimet Kontigjente dhe Pasuritë Kontigjente”** -Kontratat e ndryshueshme - Kostoja e përmbushjes së Kontratës (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022).

• **Përmirësimet vjetore të standardeve të SNRF-së Cikli 2018-2020** (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16, SNK 41).

FKGK ka zgjedhur të mos miratojë këto standarde, ndryshime në standardet ekzistuese dhe interpretime të reja përpara datave të tyre të efektshme.

2.2 Asetet Financiare dhe Detyrimet Financiare

Në shikim fillestar, një aset financiar klasifikohet si i matur me koston e amortizuar, FVOCI, ose FVTPL. Detyrimet financiare klasifikohen dhe maten me koston e amortizuar. Një aset financiar matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dy kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në FVTPL:

- aset i mbahet brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është të mbajë asete për të mbledhur flukset monetare kontraktuale; dhe
- kushtet kontraktuale të asetit financiar i japin rritje rrjedhës së parasë në data të specifikuar që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit të principalit mbi shumën e mbetur.

Një instrument borxhi matet në FVOCI vetëm nëse i plotëson të dy kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në FVTPL:

- aktivi mbahet brenda një modeli biznesi, objektivi i të cilit arrihet si nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale ashtu edhe nga shitja e pasurive financiare; dhe
- Kushtet kontraktuale të asetit financiar japin ngritje në datat e specifikuar të flukseve monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të mbetur.

Në shikim fillestar, FKGK mat një aset ose detyrim financiar në vlerën e tij të drejtë plus ose minus, në rastin e një asemi ose detyrimi financiar jo me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes, kostot e transaksionit që janë shtesë dhe i atribuohen drejtpërdrejtë blerjes ose lëshimit të asetit ose detyrimit financiar, siç janë tarifatat dhe komisionet.

Më 31 dhjetor 2020 dhe 2019, Asetet dhe detyrimet financiare të Fondit janë matur me koston e amortizuar dhe përfshijnë mjete monetare dhe ekuivalente të parave, depozitat, tregtinë, dhe arkëtimet dhe detyrimet e tjera.

Asetet financiare, ose një pjesë e tyre, ç’regjistrohen kur të drejtat e kontratës për të pranuar rrjedhën e parasë nga asetet kanë skaduar. Detyrimet financiare çregjistrohen kur shuhet (d.m.th. kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet, ose skadon).

2.3 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paranë në dorë dhe balancat në bankë me një maturim origjinal prej më pak se 3 muaj. Fondi ka llogari bankare të hapur në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe llogari rrjedhëse me Bankën për Biznes, Bankën Ekonomike, TEB Bank, Banka Kombëtare Tregtare, NLB Bank dhe Pro Credit Bank.

2.4 Prona, Impiantet dhe Pajisjet

Në pasqyrat financiare, prona, impiantet dhe pajisjet maten me koston historike të blerjes më pak amortizim të akumuluar dhe humbje nga zhvlerësimi.

Njohja fillestare

Pas blerjes së tyre fillestare të pronës, impiantet dhe pajisjet vlerësohen me koston e blerjes, e cila përfshin çmimin e blerjes, përfshirë tarifën doganore dhe çdo kosto që i atribuohet drejtpërdrejtë për sjelljen e asetit në gjendje pune.

Kostot e atribueshme drejtpërdrejtë përfshijnë kostot për përgatitjen e vendit, kostot fillestare të dorëzimit dhe trajtimit, kostot e instalimit, tarifën profesionale për njerëzit e përfshirë në projekt, taksat e pakthyeshme, etj.

Qasja e zgjedhur nga Kompania për matjen e pasuesve të pasurive, impianteve dhe pajisjeve, është modeli i koston nën SNK 16 - kostoja e blerjes është më e vogël se çdo amortizim i akumuluar dhe çdo humbje e akumuluar nga zhvlerësimi.

Fitimet ose humbjet nga ç' regjistrimi i një zëri të pronës, impianteve dhe pajisjeve (të llogaritura si diferenca midis të ardhurave dhe vlerës së mbartur të sendit) njihen neto brenda të ardhurave/ kostove të tjera në fitim ose humbje.

Metodat e Zhvlerësimit

Fondi aplikon metodën e zhvlerësimit të linjës së drejtpërdrejtë për pronat, impiantet dhe pajisjet si më poshtë:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------|
| (i) Pajisje dhe pajisje të TI-së | 3 vite (Shfrytëzueshmëri) |
| (ii) Mobilje të zyrës | 3 vite (Shfrytëzueshmëri) |
| (iii) Përmirësimet në objekt | sipas kontratës së qirasë |

2.5 Asetet e paprekshme

Në pasqyrat financiare, asetet e pa prekshme vlerësohen me kosto më të vogël të amortizimit të akumuluar dhe humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Ato përfshijnë programe softuerësh dhe licenca për përdorimin e tyre. Fondi zbaton metodën e zhvlerësimit në linjë të drejtpërdrejtë për asetet e pa prekshme një jetë të dobishme të përcaktuar 5 vjet.

2.6 E drejta e përdorimit të asetit

